



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:
“Histori dhe Gjeografi”
Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Eva TAFILI

Dr. Nevila ÇINAJ

Shtator / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Histori dhe Gjeografi”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Histori-Gjeografi
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Histori dhe Gjeografi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr.414, datë 12.11.1991
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr. 266, datë 10.08.2009
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE /4 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 6 studentë; 2021-2022 0 studentë; 2022-2023 8 studentë;
19	Komente / të tjera:	



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan (UNIEL) është një institucion publik i arsimit të lartë, i hapur me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.414, datë 12.11.1991, "Për krijimin e universiteteve në Elbasan, Gjirokastër e Korçë dhe Akademisë së Arteve në Tiranë". UNIEL, i akredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit nr.46, datë 27.11.2020, përbëhet nga 5 njësi kryesore.

Programi i studimit "Bachelor në Histori dhe Gjeografi" është një program i ciklit të parë që ofrohet pranë Departamentit të Histori-Gjeografisë të Fakultetit të Shkencave Humane në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan. Në FSHH miratoheshin degët Histori-Gjeografi dhe Gjuhë-Letërsi. Duhet thënë se të dyja këto degë vijuan të ofronin të njëjtat programe studimi, me të njëjtin emërtim, që ishin edhe programet e hapura qysh në vitin 1971, kur nisi veprimtarinë Instituti i Lartë Pedagogjik. Me pak fjalë, mund të themi se programi i studimit "Bachelor në Histori dhe Gjeografi" ka mbi 50 vjet që zhvillohet dhe është ndër më të vjetrit.

Sot, me reformimin e arsimit të lartë në Shqipëri, në përputhje me Procesin e Bolonjës, që nisi fill me nënshkrimin në vitin 1988 të *Magna Charta Universitatum*, nga 388 rektorë në Konferencë e Rektorëve Evropianë, në Universitetin e Bolonjës, si dhe me reformimin e programeve të studimit, kohëzgjatja e tij u bë 3 vite akademike, me 180 kredite ECTS. Programi i Studimit, nga emërtimi "Diplomë e nivelit të parë në Histori dhe Gjeografi" në vitin 2008-2009, është shndërruar sot në "Bachelor në Histori dhe Gjeografi", të cilin e ofron njësi bazë e titulluar Departamenti i Histori-Gjeografisë, në Fakultetin e Shkencave Humane të UNIEL. Nga viti 1971, kur është hapur për herë të parë Dega Histori dhe Gjeografi e deri në vitin akademik 2021-2022, janë diplomuar mbi 3546 studentë. Programi i studimit "Bachelor në Histori dhe Gjeografi" ka si objektiva:

1. Të ofrojë njohuritë bazë për historinë shqiptare dhe shkencën e historiografisë, si dhe për gjeografinë shqiptare e shkencën e gjeografisë në përgjithësi. Gjithashtu programi synon të japë njohuri plotësuese për ato fusha që ndihmojnë dhe japin mundësi zhvillimi të mëtejshëm, në drejtime të tjera studimi, ngushtësisht të lidhura me natyrën e historisë dhe të gjeografisë;
2. Të ketë një raport të drejtë ndërmjet bllokut të lëndëve historike dhe atyre gjeografike; një raport të drejtë ndërmjet lëndëve bazë dhe atyre karakterizuese, ndërmjet leksioneve e seminareve; detyrave të kursit dhe ekspeditave mësimore në terren;
3. Të ofrojë njohuri bazë të hyrjes në shkencën e historisë, të historisë botërore, historiografisë, historisë së Shqipërisë dhe shqiptarëve, arkivistikës, trashëgimisë historike. Ndërsa në fushën e gjeografisë parashikohen njohuri nga shkenca hartografia, gjeologjia, gjeomorfologjia; gjeografia rajonale shqiptare, gjeografia e botës, demografia, gjeografia sociale, gjeografia e trevave etj;
4. T'u japë mundësi studentëve të njohin me kompetencë dijet në fushën e historisë dhe të gjeografisë;
5. Studentet të jenë të aftë të konceptojnë, ndërtojnë dhe zbatojnë një projekt kërkimor;
6. Të zbatojnë si duhet mendimin kritik në shkencën e historisë, si dhe interpretimin me frymë objektive dhe të mbështetur në analizën e historiografisë bashkëkohore shqiptare dhe të huaj të ngjarjeve, proceseve dhe personaliteteve historike në historinë e Shqipërisë, si dhe të paraqesin e të analizojnë proceset dhe dukuritë gjeografike, ndryshimet në rajonizim dhe ndryshimet administrative, për të qenë në koherencë me të dhënat statistikore në lidhje me numrin e popullsisë, emigracionin, migrimin, etj;



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. GVJ përmbledh informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin një situatë sa më reale të mënyrës sesi paraqitet institucioni në ofrimin e këtij programi studimi (www.ascal.al, standardet).

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga ekspertët Prof. Dr. Eva Tafili dhe Dr. Nevila Çinaj. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Majlinda Demirmeli, përfaqësues i ASCAL.



Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të Jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion.

Gjithashtu, një informacion i detajuar është marrë gjatë vizitës në Departamentin e Historisë dhe Gjeografisë, Fakulteti i Shkencave Humane të Universitetit "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, të zhvilluar në datat 14-15 dhjetor 2022, sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga ekspertët.

Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet e GVJ pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UNIEL. Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV);
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve përkatëse;
- Vizita në UNIEL u zhvillua në datat 14 dhe 15 Dhjetor 2022. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit;
- Gjatë vizitës në Institucion, vlerësuesit e jashtëm kërkuar disa materiale shpesh që koordinatori i institucionit e UV, me anë të sistemit AMS, i vendosi në dispozicion dhe që u përdorën nga GVJ gjatë hartimit të raportit;
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij;

Informacionet e mbledhura dhe të shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gatishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit, gjatë vizitës në institucion.




Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 18.07.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 2/103 Prot, datë 18.07.2023. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” më datë 21.07.2023 njofton nëpërmjet sistemit, me shkresën Nr. 642/93, datë 21.07.2023 “Kthim përgjigje tuajës nr.2/103, datë 18.07.2023”, ku shpreh dakortësinë me vlerësimin e jashtëm për programin e studimit. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

-Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Histori dhe Gjeografi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Histori dhe Gjeografi” synon përgatitjen e profesionistëve, që do punojnë në sektorin privat, publik arsimor. Programi i studimit është në përputhje me misionin, vizionin dhe strategjinë e UNIEL dhe synon të formojë profesionistë që do të kontribuojnë në zhvillimin social dhe shoqëror të vendit. Ky program është në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe ligjin e arsimit të lartë dhe respekton interesat kombëtare në fushën social kulturore dhe më gjërë.</p> <p>Bazuar në dokumentacion, por edhe nga takimi me drejtuesit e njësisë baze dhe në nivel fakulteti, rezulton se misioni i Universitetit është që të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit duke ofruar arsim gjithëpërfshirës të studentëve, dhe kualifikimin e tyre në kërkim shkencor dhe veprimtari të tjera. Misioni i institucionit nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por është mbështetës i këtyre interesave. Ky program studimi synon ruajtje dhe konsolidim të vlerave akademike dhe kulturore kombëtare.</p> <p>EVIDENCA 1.1; EVIDENCA 1.2; EVIDENCA 1.3;</p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Bazuar në Statutin e UNIEL, misioni i tij është ‘të përgatisë një gjeneratë të re individësh, me formim të shëndoshë profesional e social, të aftë të ndjekin zhvillimet e shpejta ndërkombetare në pergjithësi, por vecanërisht të përshtatin e orientojnë zhvillimet në shoqërinë dhe ekonominë e vendit tonë’. Në takimin me Dekanin e Fakultetit dhe drejtuesen e departamentit, përforcau mendimin</p>



	<p>se programi i studimit është në përputhje të plotë me vizionin dhe misionin e institucionit. UNIEL ka hartuar programet e studimit në përputhje me ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Programi ka si qëllim final të kontribuojë në realizimin e misionit të UNIEL dhe objektivi i tij është formimi i profesionistëve të aftë për tregun e punës të cilët do të përgjigjen dhe do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. Mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar GVJ konstaton se programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit duke ofruar kurrikula dhe mësimdhënie cilësore.</p> <p>EVIDENCA 1.1; EVIDENCA 1.2; EVIDENCA 1.8;</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion programi i studimit Bachelor në Histori Gjeografi ofrohet në përputhje me Statutin dhe rregulloret e institucionit dhe në zbatim të strategjisë së tij për zhvillim. Ky program studimi, synon përmbushjen e qëllimeve dhe misionit të institucionit për shpërndarjen e dijes. Bazuar në takimin me drejtuesit, GVJ evidentoi që kurrikulat e programit, mësimdhënia dhe mësimnxënia, zhvillimi i studentëve dhe çështjet e ndërkombëtarizimit në këtë program studimi janë hartuar bazuar në strategjinë për zhvillim që institucioni ka hartuar. Programi i studimit është pararendësi për zhvillimin e studentëve dhe i ofron atyre mundësinë për zhvillim të mëtejshëm në ciklin e dytë të studimeve.</p> <p>EVIDENCA 1.1; EVIDENCA 1.3; EVIDENCA 1.4;</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Bazuar në statutin dhe në dokumentat në dispozicion GVJ gjykon që institucioni ka përvojën për të ofruar programin e studimit. Në statut identifikohet përvoja e gjatë që ky institucion ka. Gjithashtu GVJ bazuar në vizitën në institucion evidentoi që institucioni ka burimet njerëzore dhe kapacitetin për të zhvilluar programin e studimit Bachelor në Histori Gjeografi.</p> <p>Strukturat përgjegjëse: Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Humane, i cili ka 4 (katër) departamente dhe 1 (një) qendër kërkimore shkencore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti Histori Gjeografi; 2. Departamenti i Gjuhësisë; 3. Departamenti i Gjuhëve të Huaja; 4. Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë; 5. Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike; <p>Në Departamentin Histori Gjeografi, i cili është përgjegjës për programin e studimit, për vitin akademik 2021-2022 rezultojnë 7</p>





	<p>pedagogë efektiv (PAE) nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 3 me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 3 me gradën “Doktor” dhe 5 pedagogë me kontratë (PAK), nga të cilët janë 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 3 me gradën “Doktor” dhe 1 me “Master i Shkencave”. <i>(sipas tabelës nr.2 RVB)</i></p> <p>EVIDENCA 1.1; EVIDENCA 1.5;</p>			
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Histori dhe Gjeografi” përkon me nivelin e gjashtë të kornizës Shqiptare të Kualifikimit, dhe është përcaktuar në këtë mënyrë në bazë të rregulloreve dhe ligjit në fuqi. Institucioni i arsimit të lartë UNIEL zbaton në mënyrë rigorozë ligjin për arsimin e lartë dhe rregulloret në fuqi. Në statutin e UNIEL janë të përcaktuara të gjitha njësitë përbërëse të tij. Programi i studimit është një program i cili ofrohet nga Departamenti i Histori Gjeografisë, i cili është një nga njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Humane.</p> <p>Për programin e studimit fusha e përgjithshme ‘humane’ dhe fusha specifike ‘histori gjeografi, janë në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë përgjegjëse për këtë program studimi.</p> <p>GVJ evidentoi që klasifikimi i programit të studimit është në përputhje me direktivat evropiane dhe ligjin për arsimin e lartë në vend. Gjithashtu u evidentua në bazë të dokumentacionit që fushat e programit të studimit janë në përputhje të potë me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Humane të UNIEL.</p> <p>EVIDENCA 1.1; EVIDENCA 1.2; EVIDENCA 1.3;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit, është hartuar në zbatim të strategjisë për zhvillim të IAL-së, rezulton se është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Historisë dhe Gjeografisë dhe se ofruesit e programit Bachelor në Histori dhe Gjeografi dëshmojnë zotërojnë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për mbarëvajtjen e tij.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në funksion të hartimit, monitorimit dhe mbarëvajtjes së programit të studimit është realizuar ndarja e detyrave mes njësive të IAL, që përcaktohet nga institucioni në aktet rregullore dhe udhëzuese të tij. IAL ushtron aktivitetin e tij në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Dokumentet rregullatorë, si Statuti i Universitetit, Rregulloret, përcaktojnë dhe sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi në institucion, duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë, analizën dhe vlerësimin e vazhdueshëm. Organet kryesore dhe personeli akademik kanë mbështetjen e plotë nga struktura administrative e institucionit dhe vlerësimi i punës bëhet rregullisht si nga përgjegjësi i Departamentit edhe nga burimet njerëzore. Për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, institucioni nxit bashkëpunimin midis personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, duke siguruar një mënyrë të garantuar për të pasur marrëdhënie eficiente bashkëpunimi midis tyre në vazhdimësi. EVIDENCA 1.1; EVIDENCA 1.7</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Lidhur me realizimin e objektivave dhe të procesit mësimor e formues të studenteve, nga vizita në institucion, si dhe nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se janë nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi, siç janë ato me Universitetin e Tetovës, atë të Prishtinës dhe Institutin e Historisë Përmes marrëveshjeve sigurohen bashkëveprime të frytshme, ku përfitues janë studentet dhe personeli. Aktivitetet e kryera në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, pasqyrohen në analizën vjetore institucionale.</p> <p>EVIDENCA 1.11; EVIDENCA 1.12;</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e praktikave profesionale për programin e studimit, siç dëshmohet edhe nga evidenca.</p> <p>EVIDENCA 1.13;</p>






<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në diskutimet e zhvilluara në institucion sikurse dhe me njohjen e dokumentacionit të vënë në dispozicion evidentoit që institucioni harton periodikisht raporte analitike të marrëveshjeve të bashkëpunimit si pjesë e analizës vjetore të fakultetit dhe departamentit.</p> <p>EVIDENCA 1.34;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se në përmbushjen e kriterëve të Standardit I.2 institucioni ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda tij, ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi me homologët, si dhe ka nënshkruar marrëveshje, dhe harton raporte analitike të përfitimeve nga bashkëpunimet.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	--	-------------------------------------	------------------------------------	--

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR



<p>Standardi II.1</p> <p>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>


<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Histori Gjeografi ka në përbërje të tij lëndë në përputhshmëri me ligjin e arsimit të lartë Nr.80/2015 datë 22.07.2015 dhe gjithashtu Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët që përbëjnë këtë program janë të kategorizuara sipas ligjit të arsimit të lartë dhe përmbajnë këto kredite:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A-Lëndë bazë: (33 kredite), 18.3% • B-Lëndë karakterizuese: (93 kredite), 51.6% • C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: (24 kredite), 13.3% • D-Lëndë plotësuese: (24 kredite), 13.3% • E-Detyrime përmblylëse: (6 kredite), 3.3 % <p>Sipas vendimit të MASR Nr. 879, datë 18.12.2019 lëndët të ndara sipas kategorive duhet të kenë këtë peshë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A-Lëndë bazë: 15-20% • B-Lëndë karakterizuese: 50-55% • C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: 12-15% • D-Lëndë plotësuese: 10-15% • E-Detyrime përmblylëse: 3-5 % <p>Ky program ka 180 kredite, sipas përcaktimeve për programet Bachelor në legjislacionin për arsimin e lartë. Bazuar në dokumentacion GVJ evidentoi që plani përmban informacionet për lëndët/modulet të vlerësuara me kredite sipas sistemit ECTS si dhe siguron një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore ndërmjet semestrave. EVIDENCA 3.16;</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose</p>	<p>Programi ka si objektiv të formojë studentët me njohuri specifike në fushën e historisë dhe gjeografisë. Programi synon të bëjë një kombinim mes formimit akademik me atë praktik, veçanërisht në lëndë të caktuara. Studentët që ndjekin këtë program studimi kanë mundësi të vijojnë formimin e tyre akademik në programet e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional, Master i Shkencave, apo edhe të vijojnë karrierën e tyre profesionale, duke u punësuar në sektorin publik e atë privat.</p> <p>Programi përmban veprimtari mësimore teorike e praktike, që lidhen në mënyrë të qartë me objektivat formuese të programit të studimit në fushën e historisë dhe gjeografisë, për të qenë në koherencë me nevojat e tregut të punës për specialist në fushën e historisë dhe të gjeografisë. Studentët që ndjekin këtë program studimi përfitojnë</p>



<p>profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>një sërë njohurish nëpërmjet leksioneve, seminareve, laboratorëve, praktikave në terren dhe aktiviteteve të tjera të ofruara nga departamenti. Ky program studimi synon të përgatisë njerëz të aftë profesionalisht, për të ndjekur ciklet e tjera të studimit, si dhe t'i përgjigjen nivelit bashkëkohor të zhvillimit.</p> <p><i>GVJ konstaton se, nisur nga fakti që studentët janë të paktë në numër, aq sa viti II i Bachelorit është inekzistente, rekomandojmë që programi i studimit të ndryshojë në masën 15-20%, duke u fokusuar tek gjeografia dhe alternativat e platformës GIS.</i></p> <p>EVIDENCA 1.18;</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ, nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i evidencave, konstaton se në këtë program studimi, veprimtaritë formuese grupohen në: Lëndë bazë të programit të studimit; lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik; lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash; lëndë plotësuese - gjuhë të huaj dhe ekspeditë mësimore; detyrimet përmblylëse.</p> <p>Çdo lëndë e programit dallohet nga emërtimi. kodi dhe numri i krediteve, totali i të cilave për të tre vitet është 180.</p> <p>Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit janë mësimi në auditor dhe studimi individual, si dhe veprimtari të tjera të lidhura ngushtësisht me aspekte profesionale, si praktikë në laboratorë apo në terren.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të ketë një përmirësim të planeve mësimore dhe programeve të studimit, jo vetëm në funksion të tregut të punës, por edhe të koordinimit të veprimtarive me qendrën e studimeve Albanologjike, që mund të jetë një bazë shumë e mirë për praktikën e studentëve dhe për ofrimin e materialit didaktik.</i></p> <p>EVIDENCA 1.18; EVIDENCA 3.15; EVIDENCA 3.16; EVIDENCA 3.17;</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>GVJ, nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i evidencave, konstaton se programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p> <p>Shihet vështirësi në përplasjen e praktikave me Fakultetin e Edukimit, çka mund të shmanget duke i orientuar studentët për praktika në institucione të tjera.</p> <p>EVIDENCA 3.15; EVIDENCA 1.31;</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe</p>	<p>Numri i paktë i studentëve dhe mosekzistenca e studentëve në vitin e dytë (2020-2021), na çon të mendojmë se nevojiten ndryshime në organizimin e studimeve, duke u fokusuar në veçantitë e përgatitjes</p>

<p>financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>së studiuesve të historisë dhe gjeografisë dhe jo të mësuesve në këto disiplina.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>GVJ, nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i evidencave, konstaton se programi i studimit “Bachelor në Histori dhe Gjeografi” në UNIEL ka një ngjashmëri në përmbajtje deri të masën 70% me programet e studimit të të njëjta në Bachelor në Histori dhe Gjeografi, të Univ. Luigj Gurakuqi, Shkodër; Univ. Gjirokastrës. Po ashtu, edhe me programet e studimit Bachelor në Histori dhe atë në Gjeografi të UT; në lëndët bazë dhe lëndët karakterizuese ka një përmbajtje të ngjashme në nivel rreth 70%.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>GVJ, nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i evidencave, konstaton se programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushts së tudimit dhe klasifikimeve të bëra nga MASR. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p> <p>Janë bërë mbledhje për kodifikimin e programeve në përputhje me direktivat nënligjore, sipas fushave të historisë dhe gjeografisë.</p> <p>EVIDENCA 1.9;</p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Nga bisedat me dekanin dhe departamentin, si dhe nga këqyrja e dokumentacionit u vumë në dijeni të ekzistencës së marrëveshjeve për përafrimin e programeve, por ende nuk janë realizuar.</p> <p>S’ka programe studimi të përbashkëta me institucione të arsimit të lartë, vendas apo të huaj.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit është i organizuara në lëndë e module dhe me elementë qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, si dhe me sistemin ECTS. Ky program studimi synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh dhe jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, duke përcaktuar qartë veprimtaritë formuese dhe ngarkesën në kredite.</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane, njësia kryesore për programin Bachelor në Histori Gjeografi, është një nga 5 fakultetet e UNIEL hapur me VKM Nr, 821, datë 05.12.2007. Institucioni është akredituar në vitin 2020 me Vendimin Nr 49 të Bordit të Akreditimit për 6 vite.</p> <p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Fakulteti i Shkencave Humane përbëhet nga 5 njësi bazë të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti Histori Gjeografi; 2. Departamenti i Gjuhësisë; 3. Departamenti i Gjuhëve të Huaja; 4. Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë; 5. Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike; <p>Referuar dokumentacionit GVJ evidentoi që njësia përgjegjëse për programin Departamenti i Histori Gjeografisë ka në përbërje të tij 7 (shtatë) personel akademik efektiv (PAE), duke plotësuar në këtë mënyrë kriterin ligjor në lidhje me numrin.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se në kuadër të organizimit dhe mirëfunksionimit të veprimtarisë në Departamentin Histori dhe Gjeografi, si dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore sipas ligjit Nr. 80/2015, ecuria dhe zhvillimi i programit “Bachelor në Histori dhe Gjeografi” koordinohet nga: përgjegjësjë e departamentit. Për ecurinë e programeve, regjistrim dhe transferimeve të studentëve, sekretaria mësimore ndihmohej edhe nga teknologjia e instaluar në korridoret dhe ambientet e brendshme të fakultetit..</p> <p>EVIDENCA 1.20; EVIDENCA 1.24; EVIDENCA 1.8 neni 4.2.2;</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e</p>	<p>Referuar RVB-së, dhe vizitës në Institucion, GVJ konstaton se ecuria dhe zhvillimi i programit të studimit koordinohet nga përgjegjësi i departamentit.</p>

koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<i>GVJ sugjeron, se për një koordinim më efikas, dhe për një bashkërendim të veprimtarive për arritjen e objektivave dhe qëllimeve të programit duhet të vendoset një koordinator programi.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, si dhe ka angazhuar caktuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, Bachelor në “Histori Gjeografi”, dhe Departamenti Histori Gjeografi, disponojnë dhe kanë vënë në dispozicion të stafit akademik të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si rregulloren dhe programin mësimor.</p> <p>Në planin mësimor të cilët studentët mund të aksesojnë lehtësisht jepen këto informacione:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndët e programit sipas kategorive; - Orët për secilën lëndë, të ndara në seminare, leksione dhe orë individuale; - Raporti i orëve Leksion/Seminar; - Kreditet e lëndëve; <p>EVIDENCA 1.14; EVIDENCA 3.16;</p>


<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Histori Gjeografi ka të hartuar planin mësimor i cili përmban informacionin e nevojshëm të shpërndarë në tre vitet akademike. Bazuar në dokumentacion GVJ evidentoi që plani mësimor i këtij programi studimi përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emertimi i lëndëve/moduleve të programit të studimit sipas semestrave; • Numrin e krediteve për çdo lëndë/modul dhe raportin e orëve (leksione dhe seminare) të ndara në semestër; • Detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi etj); • Mënyra e kontrollit të dijeve të çdo lëndë/moduli (semestri, provim ose provim i ndërmjetëm) numrin e provimeve dhe javëve mësimore; <p>GVJ evidentoi përgjatë vizitës në institucion se i gjithë programi i studimit i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet formave fizike dhe elektronike</p> <p>EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 3.15;</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Institucioni bazuar në ligjin e arsimit të lartë ka hartuar dhe shpallur informacionin lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin transferimin dhe ekuivalentimin e studentëve.</p> <p>Sipas Vendimit Nr.41 date 28.01.2020, kriteret e pranimit të studentëve të ciklit të parë në Fakultetin e Shkencave Humane, shprehen nga formula ku janë në masën 70% të pikëve nga nota mesatare e shkollës së mesme, sipas kriterit të notës mesatare të përcaktuar në VKM për vitin akademik 2019-2020, dhe në masën 30%, të pikëve nga nota mesatare aritmetike e gruplëndëve sipas programeve të studimit në të gjitha vitet ku shtrihen lëndërt.</p> <p>EVIDENCA 1.23;</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminar apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ konstaton se plani mësimor i programit “Bachelor në Histori dhe Gjeografi” e përfshin informacionin e nevojshëm në lidhje me komponentët mësimorë, për sa u përket leksioneve, seminareve, si dhe të gjithë komponentët formues të programit, brenda dhe jashtë auditorit. Në to përfshihet edhe informacioni për vlerësimin e dijeve të përfituara, përmes kombinimit të vlerësimit të vazhduar, me atë përfundimtar. Rregullat për frekuentimin/ndjekjen e programit, si dhe vlerësimin e njohurive përcaktohen në rregulloren e programit, si dhe në syllabus-et e lëndëve.</p> <p>EVIDENCA 1.18; EVIDENCA 1.15; EVIDENCA 3.15; EVIDENCA 3.16;</p>


<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përmirësimet dhe ndryshimesh të syllabuseve duhet të bazohen në rregullore. GVJ bazuar në vizitën në intitucion u informua se procedura për ndryshimin dhe përmirësimin e syllabuseve është: syllabuset diskutohen në fillim të cdo viti akademik dhe dokumentacioni firmoset nga titullari i lëndës dhe përgjegjësi i departamentit. Këto përmirësime reflektohen në përmirësimin e përmbajtjes, literaturës, metodologjisë, etj, duke sugjeruar ndryshime në funksion të përmirësimit të saj, apo të përshtatjeve me ndryshimet ligjore. Këto kryhen përmes analizës vjetore të departamentit.</p> <p>Ndryshimet e propozuara kalojnë për miratim në Senatin Akademik dhe i përcillen për njoftim MASR., kur nuk e kalojnë 20% të masës së ndryshimeve në program. Ndryshimi i programeve të studimit në masën 20% ishte realizuar në fillim të vitit akademik 2021-2022.</p> <p>EVIDENCA 1.31; EVIDENCA 1.33; EVIDENCA 1.34; EVIDENCA 3.8;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se FSHH dhe Departamenti Histori-Gjeografisë, përkatësisht si njësi përgjegjëse kryesore dhe bazë për programin e studimit “Bachelor në Histori dhe Gjeografi”, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Ky program përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët, i cili lidhet me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit / ripranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kryhen përmirësime që reflektohen në përmirësimin e përmbajtjes, literaturës, metodologjisë, etj., si dhe në kurrikul, duke sugjeruar ndryshime në funksion të përmirësimit të saj, apo të përshtatjeve me ndryshimet ligjore. Studentëve u sigurohet informacioni i nevojshëm në lidhje me komponentët mësimorë, për sa u përket leksioneve, seminareve, si dhe të gjithë komponentët formues të programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi II.4



Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Histori Gjeografi është ndërtuar për të mundësuar marrjen e njohurive nga studentët në fushën e histori gjeografisë. Bazuar në dokumentacion GVJ evidentoi që emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të këtij programi studimi janë përcaktuar në mënyrë që të arrijnë objektivin e dhënies së njohurive për studentët dhe njëkohësisht të mundësojnë zhvillimin e mëtejshëm të studimeve për këta studentë. GVJ bazuar në vizitën në institucion evidentoi në takimet me studentët që zhvillimi i mësimin në këtë program është në funksion të rritjes së interaktivitetit ndërmjet tyre dhe pedagogëve.</p> <p>Kështu lëndët e formimit bazë zhvillohen të gjitha në vitin e parë të studimeve, ndërsa ato karakterizuese në vitin e dytë dhe të tretë, sipas specifikave të tyre dhe duke ndjekur një kronologji e logjikë shkencore të ndarjes dhe zhvillimit të tyre në semestra. Këtyre lëndëve u bashkohen edhe lëndët me zgjedhje, si një mundësi e studentit për të marrë njohuri dhe zhvilluar aftësi në lëndë të caktuara, që i përkasin grupit të lëndëve ndërdisiplinore/integruese.</p> <p>Përmes praktikave synohen profesionistë me njohuri të përmirësuara, por në kushtet kur tregut të punës nuk i duhen të tillë, atëherë praktikantët duhen orientuar tek Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanike, si dhe tek zyra e marrëdhënieve me publikun. EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 3.15; EVIDENCA 3.16;</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstatoi se ky program studimi ofrohet në 3 vite akademike. Programi organizohet në 6 semestra gjithsej, me kohëzgjatje normale 15 javë në një semestër. Në përfundim të këtij programi studentët marrin 180 kredite (ECTS). Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe shpërndarja e krediteve sipas lëndëve bën të mundur arritjen e objektivave formues të këtij programi studimi dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe arsimit profesional. Plani mësimor i programit të studimit siguron një shpërndarje të tillë të lëndëve në të tre vitet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A-Lëndë bazë: (33 kredite), 18.3%, Ku ligji detyron 15%-20% • B-Lëndë karakterizuese: (93 kredite), 51.6%, Ku ligji detyron 50%-55% • C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: (24 kredite), 13.3%, Ku ligji detyron 12%-15% • D-Lëndë plotësuese: (24 kredite), 13.3%, Ku ligji detyron 10%-15%



	<ul style="list-style-type: none"> E-Detyrime përmbyllyse: (6 kredite), 3.3 %, Ku ligji detyron 3%-5% <p>Bazuar në këtë shpërndarje GVJ konstaton që lëndët janë të shpërndara dhe të vlerësuara me kredite në përputhje me ligjin në fuqi.</p> <p>EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 3.15; EVIDENCA 3.16;</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ bazuar në planin mësimor evidentoi që lëndët dhe struktura e programit mësimor është në përputhje me profilin e këtij programi studimi. Në planin mësimor pasqyrohet informacioni në lidhje me shpërndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor, orët jashtë auditorit, detyrimin për frekuentimin dhe mënyrën e vlerësimit për secilin element sipas sistemit të vlerësimit të integruar. Plani mësimor është i hartuar me përbërësit specifikë, me lëndë bazë, karakterizuese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllyse. EVIDENCA 3.16;</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit.</p> <p>Ndarja sipas veprimtarive formuese në program është në përputhje të plotë me përcaktimet në shtojcën nr. 2 të VKM nr. 41. datë 24.01.2018 (15% - 20% kredite lëndë bazë, 50%-55% kredite lëndë karakterizuese, 12%-15% kredite ndërdisiplinore/integruese, 10%-15% kredite plotësuese).</p> <p>Peshën më të madhe në program e kanë lëndët karakterizuese, pasi ato i përgjigjen pjesës më të madhe të kompetencave që synon ky i fundit në formimin e specialistëve të fushave të historisë dhe gjeografisë.</p> <p>EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 3.15; EVIDENCA 3.16;</p>


<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, përkatësisht syllabuset e lëndëve, GVJ konstatoi se në përgjithësi në syllabusin e cdo lënde paraqitet informacion i detajuar. Ajo që u konstatua përgjatë komunikimeve në institucion ishte që syllabuset e lëndëve përmirësoheshin nga lektorët cdo vit bazuar në ndryshimet që ndodhin dhe të rejat më të fundit.</p> <p><i>Departamentit i mungon një strategji e tregut të punës, si dhe nuk ka një studim të mirëfilltë me të punësuarit e diplomuar në vitet e mëparshme, ekziston baza materiale e blerë për të instaluar teknologjinë GIS që do të mundësonte punësimin e një numri të konsiderueshëm të diplomuarish, por ajo ende nuk është vënë në zbatim. EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 3.15; EVIDENCA 3.16;</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, duke i përgatitur studentët në mënyrën e duhur për të vazhduar programet e ciklit të dytë të studimit. Përmes këtij programi studimi, studentët pajisen me dije e aftësi, njohuri të nevojshme në fushën e historisë dhe gjeografisë, çka u mundëson studentëve të vijojnë më tej në ciklin e dytë të studimeve, në MP dhe MSH, që synohet të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij, për kualifikimin e nevojshëm dhe specializimin në fushat përkatëse dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 3.15; EVIDENCA 3.16; EVIDENCA 3.17;</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Histori Gjeografi, njohuri të marra në këtë program mundësojnë thellimin e tyre të mëtejshëm për studentët në cikle më të larta studimi. Lëndët e programit të studimit janë në nivelin bazik dhe shumë prej tyre për thellimin e mëtejshëm akademik apo për profilizimin profesional mundësojnë vijimin e studimeve më të thelluara në ciklin e dytë të studimeve. Synimi i Departamentit të Histori-Gjeografisë në këtë program është përgatitja e studentëve si studiues e profesionistë, në përputhje me dinamikën dhe nevojat e tregut të punës.</p> <p><i>GVJ sugjeron se duhet thelluar studimi mbi ofertën e tregut të punës.</i></p> <p>EVIDENCA 1.3; EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 1.20; EVIDENCA 3.17;</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të studimit “Bachelor në Histori dhe Gjeografi”, ndarja në kategori e veprimtarive formuese dhe shpërndarja e lëndëve bën të mundur që përfitohen njohuri të aftësitë e nevojshme për të</i></p>

	<p>vijuar me arsimimin e studentëve në ciklin e dytë. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh përcaktimet në lidhje me strukturën e tij sipas kriterëve të vendosura nga VKM nr. 41, si dhe në përputhje me Statutin dhe aktet e tjera të UNIEL-it. Syllabus-et përditësohen vazhdimisht mbi bazën e nevojave dhe zhvillimeve në fushat e studimit, mbi bazën e propozimeve të titullarit të lëndës dhe diskutimeve në nivel departamenti.</p> <p>Programi synon të jetë një ofertë akademike nxitëse dhe konkurruese, që u ofron studentëve mundësinë për të thelluar dijet dhe të kualifikohen më tej në fushën e historisë e gjeografisë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Referuar RVB-së, GVJ konstaton se fakulteti dhe departamenti kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm me institucione të ndryshme, si pjesë e politikës së institucionit për të forcuar bashkëpunimin dhe lidhjen e mësimdhënies me praktikën.</p> <p>Për të përshtatur kurrikulën universitare, departamenti ndjek nga afër politikat arsimore të hartuara nga MASR, nevojat për të diplomuar specialistë të fushës së historisë dhe gjeografisë, në përputhje me trendin e zhvillimit për specialistë të këtyre fushave, si dhe reformën në arsimin parauniversitar e në arsimin e lartë. Departamenti ishte pjesë e organizimeve të Panairit të Karrierës dhe nuk mungonin përpjekjet për të paraqitur tek bizneset lokale mundësinë e punësimit të të diplomuarve.</p> <p>EVIDENCA 1.17; EVIDENCA 1.31; EVIDENCA 5.6;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të</p>	<p>Bazuar në dokumentacion GVJ evidentoi organizimin dhe përfshirjen e studentëve dhe stukturave të tyre në diskutime për përmirësimin e programit të studimit. Në dokumentat e vëna në dispozicion studentët janë të angazhuar në Senatën Akademik UNIEL dhe në Këshillin studentor. Ato kanë të hartuar dhe zbatojnë rregulloret e tyre. GVJ përgjatë diskutimit me studentët në</p>

studimit dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	<p>institucion evidentoi disa kërkesa të tyre në lidhje me programin e studimit, për përmirësimin e tij.</p> <p><i>Institucioni nuk dëshmon se mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit dhe takimeve me titullarët e fakultetit, konstatoi së është në fokus të institucionit bashkëpunimi me organizatat/kompanitë publike dhe private, institucione kërkimore e shkencore, duke i pare si pjesë integrale e aktivitetit të Fakultetit të Shkencave Humane. Ajo që kërkohet të arrihet nga keto bashkëpunime është të merren kërkesa specifike lidhur me profesione të kërkuara nga tregu dhe njëkohësisht edhe vetë programet e studimit të përshtaten në mënyrë të tillë që ti përgjigjen në mënyrë më eficiente plotësisht të nevojave të formimit.</p> <p><i>Rekomandohet që marrëveshjet ekzistuese të jenë funksionale, për të siguruar edhe bashkëveprime të frytshme, në përfitim të studentëve dhe personelit.</i></p> <p>EVIDENCA 1.11</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se fakulteti dhe departamenti kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm me institucione të ndryshme, si pjesë e politikës së institucionit për të forcuar lidhjen e mësimeve me praktikën, si dhe për të përmirësuar e përshtatur kurrikulën e programit. Ndryshimet e mundshme në kurrikulën e këtij programi studimi janë pjesë e një debati shkencor që pasqyron filozofinë e Departamentit të Histori-Gjeografisë, për t'u ofruar studentëve në tërësi marrjen e ekspertizës më të mirë të profesorëve, jo vetëm të Departamentit të Histori-Gjeografisë, por edhe të personelit të ftuar, si nga UT, ashtu edhe të qendrave të tjera studimore e akademike në Shqipëri. Në përmirësimin e programit të studimit bëhen pjesë aktive edhe studentët, por jo ata të diplomuar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	--------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton që leksionet, laboratorët, detyrat e kursit/ esetë, praktikat profesionale dhe orët e hapura, janë format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe të transmetimit të njohurive.</p> <p>Departamenti organizon leksione të hapura, ku ftohen studiues apo profesionistë të ndryshëm vendas apo të huaj, për tema të caktuara dhe me interes për studentët e fushës. Format e mësimdhënies/mësimnxënies rregullohen në mënyrë të detajuar në Rregulloren e UNIEL-it dhe Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>EVIDENCA 1.5; EVIDENCA 1.6;</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstaton se është verifikuar që stafi pedagogjik u përgjigjet me seriozitet larmisë dhe nevojave të studentëve. Pedagogët, në përputhje me natyrën e programit, ofrojnë metoda dhe mundësi alternative (shembuj realë, etj.) në mënyrë që studenti të rrisë interesin dhe dëshirën e të nxënit.</p> <p>Gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët, u sollën shembuj të ofrimit nga ana e pedagogëve të metodave të ndryshme, për ta bërë lëndën sa më të kuptueshme dhe të qartë për studentin.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Për të rritur kompetencat didaktike stafi pedagogjik të këtij program studimi përfshihet në trajnimet dhe mësimdhënien në kuadër të programit Erasmus. Lista e bashkëpunimeve dhe e stafit pjesëmarrës në këtë program evidenton mbështetjen e institucionit për rritjen e kompetencave didaktike nëpërmjet trajnimeve nga institucione të huaja të arsimit të lartë. Stafit akademik gjithashtu i jepet mundësia të përdorë mjetet bashkohore audio-vizive në mësimdhënie. GVJ bazuar në dokumentacion identifikoi që përmirësimi i kompetencave të stafit akademik në këtë program studimi mund të zhvillohet dhe nga bashkëpunimi që ata kanë me lektorë të ftuar të fakultetit apo dhe ekspertë të fushës me të cilët ata kanë bashkëpunim. EVIDENCA 3.2; EVIDENCA 6.4;</p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në Histori Gjeografi për vitin akademik 2021-2022, përbëhet nga: (tabela 6.3 RVB)</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 Prof.Dr; • 4 Prof.Asoc; • 6 Dr; <p>Referuar këtyre të dhënave, eksperiencës së stafit dhe kualifikimeve të tyre GVJ gjykon që personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi është kompetent për transferimin e dijeve dhe njohurive tek studentët. Gjatë vizitës dhe bashkëbisedimit me stafin dhe studentët konstatuam interaktivitetin ndërmjet studentëve dhe stafit akademik sikurse dhe mbështetjen që ky i fundit i jepte studentëve për avancimin e tyre akademik dhe për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndosha midis tyre. EVIDENCA 4.18;</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane, është njësia kryesore që ofron programin e studimit Bachelor në “Histori Gjeografi”. Studentët e regjistruar në këtë program studimi kryejnë vlerësimin e formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në këtë aspekt, studentët vlerësojnë pedagogët në mënyrë anonime si edhe nëpërmjet fokus-grupeve me studentë për marrjen e mendimit të tyre, ku këto vlerësime mbeten një nga elementët kryesorë për arritjen e cilësisë akademike. Këto mënyra vlerësimi u evidentuan edhe gjatë vizitës dhe janë pasqyruar dhe pasqyrohen edhe në raportet që lidhen me vlerësimet e studentëve. Në vijim, personeli akademik i angazhuar në këtë program, kryen vlerësimet e tij lidhur me procesin e mësimdhënies, gjë që në tërësi i vlen përmirësimin të formave dhe metodave të përdorura gjatë këtij procesi.</p> <p>EVIDENCA 1.33; EVIDENCA 1.34;</p>


<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstaton se në nivel njësie kryesore është ngritur tashmë struktura që merret me kontrollin dhe monitorimin e cilësisë, ku ky sistem i sigurimit të brendshëm të cilësisë drejtohet nga Komisioni i Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit. Ky komision ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë.</p> <p>Departamenti i Histori-Gjeografisë organizon struktura/grupe pune që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësitë kryesore. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p>EVIDENCA 1.17; EVIDENCA 1.18; EVIDENCA 1.31; EVIDENCA 5.1;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ evidentoi që institucioni garanton transferimin e njohurive dhe mësimdhënie efektive bazuar në eksperiencat dhe kualifikimet që stafi akademik ka dhe metodologjinë që ata përdorin. Institucioni bën përpjekje për përmirësimin e vazhdueshëm në mënyrë që të sigurojë arritjen maksimale të rezultateve. Njësia përgjegjëse dhe personeli i saj akademik vlerësojnë e përmirësojnë format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces, përmes reflektimit të mendimeve të tyre. Në nivel njësie kryesore është ngritur tashmë struktura që monitoron dhe kontrollon cilësinë, si dhe që ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2



Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret



Vlerësimi i ekspertëve



<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor dhe në syllabusin e secilës lëndë.</p> <p>Sipas <i>nenit 16</i> të kësaj rregulloreje vlerësimi në lëndë mund të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Provim me shkrim, me gojë ose i ndërthurur; - Me detyra kursi projekte postera; - Bazuar në shumëllojshmëri formash vlerësimi; <p>Studentët janë të njohur paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet e tyre në lidhje me testimin dhe vlerësimin e njohurive. Vlerësimi i studenteve realizohet nëpërmjet sistemit të pikëve 0-100, të cilat konvertohen në nota (4-10).</p> <p>EVIDENCA 1.8</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët GVJ evidentoi njohurinë e tyre të plotë në lidhje me format e vlerësimit për secilën lëndë. Bazuar në informacionin e dhënë nga studentët, secili lektor lëndë në javën e parë të realizimit të mësimin i bën studentëve me dije mënyrën e vlerësimit. Testimi dhe vlerësimi i njohurive në këtë institucion ishte pjesë e syllabuseve të lëndëve të programit mësimor.</p> <p>EVIDENCA 3.16; EVIDENCA 3.17;</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ iu bënë me dije nga studentët dhe stafi akademik se testimi i njohurive dhe dijeve realizohej në mënyra të ndryshme në këtë program studimi. Kjo ishte e bazuar në karakteristikat e lëndës dhe zhvillohej për ti dhënë mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë e mara në mënyra të ndryshme. Bazuar në informacionin e marrë në institucion GVJ evidentoi që testimi i njohurive në këtë program studimi ishte i alternuar në mënyra të ndryshme që i jepte mundësi studentëve për të shprehur në mënyra të ndryshme përvetësimin e njohurive. EVIDENCA 1.7; EVIDENCA 1.8;</p>

<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë/personeli akademik bën përpjekje të vazhdueshme për të përditësuar metodat e ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe synimi parësor i të gjitha metodologjive të përdorura në mësimdhënie është që të nxisë tek studentët mendimin krijues, atë kritik, si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Personeli akademik i angazhuar në këtë program siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë pedagog-student.</p> <p>EVIDENCA 1.17; EVIDENCA 1.18; EVIDENCA 1.20;</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se UNIEL-i mbështet dhe ofron mundësinë e mobilitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademik pranë universiteteve partnere, për përmirësimin e kompetencave të tyre.</p> <p>Njësia bazë që mbulon programin e studimit “Bachelor në Histori dhe Gjeografi”, në bashkëpunim me Rektoratin, mbështet personalin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, duke u bazuar në rezultatet e të nxënësve, përmes formave të ndryshme të kontrollit të dijes, si dhe anketimeve të zhvilluara me studentët.</p> <p>EVIDENCA 1.1; EVIDENCA 3.18; EVIDENCA 1.17; EVIDENCA 3.1; EVIDENCA 3.5; EVIDENCA 3.7.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se rregulloja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrat e kontrollit të dijeve/vlerësimit në lëndë të ndryshme. Studentët informohen në fillim të çdo lënde mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabus-et përkatëse. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve e aftësive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, ku studentit i jepet mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Vlerësimi i njohurive ndërtohet jo vetëm përmes provimeve me shkrim, me gojë apo të kombinuara, por edhe përmes detyrave të kursit, kontrolleve të vazhdueshme të dijes. Njësia bazë/personeli akademik bën përpjekje të vazhdueshme për të përditësuar metodat e mësimdhënies interaktive, ku synimi parësor i metodologjive të përdorura në mësimdhënie është nxitja tek studentët e mendimit krijues, atij kritik, si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. UNIEL-i mbështet dhe ofron mundësinë e mobilitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademik pranë universiteteve partnere, për përmirësimin e kompetencave të tyre.</i></p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3



Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si dhe nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet, përmes kontrolleve të vazhdueshme të dijes gjithë vitit akademik. Titullari i lëndës ka detyrën e vlerësimit të studentëve përgjërë të vitit akademik. Provimi realizohet me pjesëmarrjen e komisionit të provimit, të miratuar nga drejtuesi i departamentit, që përbehet nga titullari i lëndës dhe asistenti i tij. Në rastet kur lënda është realizuar vetëm nga një pedagog, në komision merr pjesë një pedagog i fushës ose i një disipline akademike të afërt. Pedagogu tjetër, ndihmon në procesin e administrimit të provimit, pa qenë pjesë e procesit të vlerësimit, por duke ndihmuar në këtë proces.</p> <p>EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 1.14; EVIDENCA 3.16; EVIDENCA 3.17;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si dhe nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se në programin e studimit “Bachelor në Histori dhe Gjeografi” nuk përdoren sistemet elektronike të vlerësimit. Përgjithësisht forma e përdorur për realizimin e testeve është e bazuar në vlerësimin tradicional. Për grupet që kanë numër të konsiderueshëm studentësh, përdoret metoda e sekretimit nga përfaqësuesit e sekretarisë mësimore, me qëllim që të ruhet anonimat i studentit. Së fundmi, po përdoren si metoda dhe dorëzimi i detyrave të kursit nëpërmjet adresës elektronike dhe sakaq pasqyrimi i vlerësimit të studentit kryhet nëpërmjet sistemit EMS. EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 1.14;</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i cdo lëndë bëhet me gojë ose me shkrim në përputhje të plotë të syllabusit dhe bazës ligjore në fuqi. GVJ evidentoi që studentët ishin të informuar për mënyrën e vlerësimit përfundimtar për secilën lëndë/modul të zhvilluar. GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion evidentoi që në rregulloret dhe bazat ligjore në UNIEL ishin të përcaktuara format e vlerësimit</p>

	të cilat i bëheshin me dije studentëve në fillim të vitit akademik. EVIDENCA 3.17;
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	GVJ gjatë takimit në institucion u informua se stafi akademik punonte ngushtësisht me studentët për përmirësimin e tyre. Ata i vënë në dispozicion studentëve tezat e zgjidhura për të evidentuar problematikat e tyre dhe këshillojnë për përmirësimet në të ardhmen. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback në rastet e kontrolleve të vazhdueshme të dijeve, prezantimet e detyrave, angazhimit në projekte, realizim detyrash kursi, duke i këshilluar studentët mbi procesin e të nxënimit (arritjet dhe mangësitë e tyre), për ta ndihmuar studentin që të përmirësohet në të ardhmen. EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 3.15;
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në vizitën në institucion GVJ konstatoi se për të shmangur mundësitë e plagjiaturës përgjatë provimit, studentët do të duhet të jenë të pajisur me mjet identifikimi, të mos përdorin celularët dhe cdo formë e shkeljes së rregullores së provimit i bën ata të përjashtohen nga ky i fundit. Stafi akademik nuk toleron asnjë formë të kopjos apo plagjiaturës duke e dënuar atë sipas rregulloreve në fuqi. Autoriteti vendimarrës për këtë të fundit është stafi akademik përgjegjës për zhvillimin e provimit. EVIDENCA 1.4; EVIDENCA 1.7; EVIDENCA 1.14; EVIDENCA 6.5;
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga vizita në institucion, si dhe nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se korrigjimi i provimit për lëndën mësimore bëhet nga pedagogu titullar. Nota përfundimtare vjen si rezultat i kombinimit të frekuentimit (pjesëmarrja dhe aktivizimi në leksione), kontrollit të vazhdueshëm (dorëzimi i detyrave/projekteve; provimi i ndërmjetëm/kolokiumi dhe provimi përfundimtar, që ka pjesën e luanit në vlerësimin përfundimtar. Pikëzimi sipas këtyre elementëve të mësipërm u bëhet i ditur studentëve nga sekretaria mësimore. Vlerësimi u bëhet e ditur studentëve brenda afateve të përcaktuara në rregulloren përkatëse. Këto rregulla u bëhen të ditura studentëve përmes syllabus-eve të lëndëve. EVIDENCA 1.7; EVIDENCA 3.17;




<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Departamenti përgjegjës për programin e studimit, garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studentët kanë qasje në rezultatet personale të provimeve, në respektim të parimit të konfidencialitetit. Procedura për ankimimet e studentëve është e pasqyruar në rregullore. Në rast ankimimi, njësia bazë ngre komisionin e shqyrtimit të ankimimit, i cili shqyrton dhe jep vlerësimin përfundimtar për studentin. Në përfundim komisioni relaton tek drejtuesi i departamentit.</p> <p>EVIDENCA 1.7 neni 44; EVIDENCA 1.14;</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Lidhur me shqyrtimin e ankesave të studentëve, nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se, kur drejtuesi i departamentit vlerëson se ajo është e drejtë, me urdhër ngarkon një komision “ad hoc”, (në përbërje të të cilit janë anëtarët e komisionit të provimit, por edhe pedagogë të tjerë) që të rivlerësojë edhe njëherë provimin dhe të bëjë ballafaqim me studentin. Komisioni merr vendim për rivlerësimin i cili është i formës së prerë dhe depozitohet në departament e në sekretarinë mësimore. Rezultati i rivlerësimit pasqyrohet në sistem. Kur studenti ankohet për vlerësimin e marrë në një provim, ku drejtuesi i departamentit është anëtar i komisionit të provimit, në këtë rast ankesa i drejtohet dekanit. Kur dekani vlerëson se ajo është e drejtë, ngarkon një komisionin “ad hoc” (në përbërje të të cilit janë anëtarët e komisionit të provimit, por edhe pedagogë të tjerë), që të rivlerësojë edhe njëherë provimin dhe të bëjnë ballafaqim me studentin. Komisioni merr vendim për rivlerësimin. Vendimi i këtij komisioni “ad hoc” është i formës së prerë dhe depozitohet në departament e në sekretarinë mësimore, Rezultati i rivlerësimit pasqyrohet në sistem. EVIDENCA 1.7 neni 44</p>



<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale realizohet, përmes kontrolleve të vazhdueshme të dijës gjithë vitit akademik dhe pasqyrohet në vlerësimin përfundimtar. Përgjithësisht, forma e përdorur për realizimin e testimeve bazohet në vlerësimin tradicional.</i></p> <p><i>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Në çdo syllabus janë përcaktuar mënyrat e vlerësimit, si dhe ngarkesa që çdo element vlerësues zë në vlerësimin përfundimtar.</i></p> <p><i>Njësia përgjegjëse dhe personeli akademik nuk e lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime e detyra. Këto detyrime parashtrohen në rregulloret e institucionit dhe Kodin e Etikës, ku pasqyrohen ndëshkimet për raste të tilla.</i></p> <p><i>Procedura për ankimimet e studentëve është e pasqyruar në rregullore. Njësia bazë ngre komisionin e shqyrtimit të ankimimit, në rast ankimimi, që shqyrton dhe jep vlerësimin përfundimtar për studentin. Lidhur me shqyrtimin e ankesave të studentëve, kur drejtuesi i departamentit vlerëson se ajo është e drejtë, ngarkon një komision "ad hoc", ku bëjnë pjesë edhe anëtarët e komisionit të provimit, që të rivlerësojë edhe njëherë provimin dhe të bëjë ballafaqim me studentin. Në rast se studenti ankohet për rivlerësimin, kërkesa i adresohet dekanit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4</p>	
<p>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me kornizën Shqiptare të kualifikimit niveli Nr. 6 përsa i përket njohurive që ofron nëpërmjet leksioneve, seminareve dhe praktikave profesionale. Mbështetur tek Programet e Lëndëve (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Histori Gjeografi si dhe në diskutimet me pedagogët dhe studentët, konstatohet se gjatë zhvillimit të mësimin në këtë program përdoren metoda të cilat janë në funksion të thellimit të njohurive për studentët. Nëpërmjet leksioneve merren njohuritë bazë dhe ato më</p>



	<p>të thelluara, të cilat aplikohen në seminareve ku studentët zhvillojnë aftësitë profesionale dhe nëpërmjet projekteve të kursit thellohen aftësitë analitike për zgjidhjen e problemeve.</p> <p>EVIDENCA 3.16; EVIDENCA 3.17</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Referuar planit mësimor, GVJ konstaton se programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e shkencave humane, përkatësisht, në fushën e historisë dhe atë të gjeografisë, si dhe në fushat e trashëgimisë kulturore, historike e natyrore. Tipologjia e lëndëve karakterizuese e plotësuese që ofron ky program, u zhvillon aftësi të veçanta studentëve, sipas prirjeve të tyre në fushën e historisë apo të gjeografisë.</p> <p>EVIDENCA 3.15; EVIDENCA 3.16; EVIDENCA 3.17</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit “Bachelor në Histori dhe Gjeografi” është ndërtuar mbi bazën e formimit të kompetencave dhe aftësive që lidhen me njohuritë bazë për historinë shqiptare të Shqipërisë dhe shkencën e historisë, si dhe mbi gjeografinë shqiptare e botërore, sipas fushave specifike. Gjithashtu, jepen njohuri plotësuese për ato fusha që ndihmojnë dhe japin mundësi zhvillimi të mëtejshëm, në drejtime të tjera studimi, ngushtësisht të lidhura me natyrën e historisë dhe gjeografisë, që fiton studenti, të cilat paraqiten në programin e studimit dhe syllabus-et e çdo lënde. Të gjitha këto objektiva analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës dhe stafi akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme, si dhe i orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. Nga vizita në institucion, si dhe nga evidencat, GVJ konstaton se në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah të gjitha çështjet më të rëndësishme, që analizohen e shqyrtohen dhe stafi akademik orienton studentët jo vetëm për zbatimin e tyre, por edhe për detyrimet përmbyllëse.</p> <p>EVIDENCA 3.15; EVIDENCA 1.31;</p>

<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Referuar planit mësimor, syllabuseve si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, rezulton se në procesin e mësimdhënies organizimi i orës së mësimi i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale, zhvillim kompetencash si dhe aplikim i njohurive të siguruara nga teoria. Bazuar në takimin me stafin akademik dhe studentët na u bë me dije se në lëndë të ndryshme kishte përfshirje të detyrave të kursit shpesh duke mbështetur idetë inovative dhe mbi të gjitha bashkëpunimin dhe interaktivitetin. Këto detyra kursi shërbejnë dhe si një bazë e mirë pr të rritur aftësitë e kërkimit shkencor duke mundësuar një familjarizim me procesin e kërkimit. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet studentët, duke ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p> <p>EVIDENCA 1.18; EVIDENCA 1.20; EVIDENCA 3.2; EVIDENCA 4.6; EVIDENCA 4.7; EVIDENCA 4.8;</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si dhe nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se stafi akademik efektiv dhe me kontratë, që zhvillon mësim në programin e studimit "Bachelor në Histori dhe Gjeografi" realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë, brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit. EVIDENCA 3.1; EVIDENCA 3.2; EVIDENCA 3.18;</p>





Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit “Bachelor në Histori dhe Gjeografi” garanton thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta tek studentët, si dhe garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e shkencave humane, përkatësisht, në fushën e historisë dhe atë të gjeografisë, si dhe në fushat e trashëgimisë kulturore, historike e natyrore.</i></p> <p><i>Ky program studimi jep njohuri plotësuese për ato fusha që ndihmojnë dhe japin mundësi zhvillimi të mëtejshëm, në drejtime të tjera studimi, ngushtësisht të lidhura me natyrën e historisë dhe gjeografisë, që fiton studenti, të cilat paraqiten në programin e studimit dhe syllabus-et e çdo lënde.</i></p> <p><i>GVJ evidentoi që në këtë program studimi garantohet marrja dhe thellimi i njohurive bazuar në mënyrën e zhvillimit të lëndëve të programit. Në këtë program inkurajohet interaktiviteti, idetë novatore dhe aftësimi i studentëve dhe jashtë vendit me anë të mobiliteteve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X



Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	<p>Referuar rregulloreve të institucionit programi i studimit, përmbyllet me provim përfundimtar ose me punim diplome. Bazuar në vizitën në institucion GVJ evidentoi që për të përmbyllur studimet me punim diplome studentët mund të zgjidhnin vetëm në momentin që mesatarja e studimeve të tyre është me e lartë se 8.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet gjithashtu dhe nota që duhet të marrë student për të përmbyllur programin e studimit. Studentët mund të japin provimin përfundimtar vetëm në momentin që kanë arritur të marrin të gjitha lëndët e programit minimalisht me notën kaluese (5), dhe të mbrojnë diplomën kur mesatarja e të gjithë lëndëve të programit të studimit janë mbi 8.</p> <p>EVIDENCA 3.10; EVIDENCA 3.11; EVIDENCA 1.2;</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët,	<p>GVJ konstaton se pedagogët i njohin studentët në fillim të vitit akademik me objektivat e tyre për kërkim shkencor, me qëllim që të shfrytëzohen si tema punimi. Çdo student përzgjedh pedagogun</p>



<p>duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>udhëheqës, në varësi të interesave që shfaq për të studiuar. Pedagogu dhe studenti bashkëpunojnë intensivisht përgjatë vitit akademik, me takime, përmes adresës elektronike, konsultimeve, etj. Studentët pajisen me literaturën dhe materialet e nevojshme për të realizuar kërkimin shkencor. Departamenti i Histori-Gjeografisë, bashkë me stafin akademik të angazhuar në këtë program, ka ndërtuar dhe vënë në dispozicion të studentëve grup-pyetjet për provimin përfundimtar, sipas fushave (histori dhe gjeografi), në mënyrë që të informojnë e udhëzojnë studentët në funksion të detyrimeve përmbyllëse. EVIDENCA 3.11; EVIDENCA 1.8;</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>GVJ konstaton se komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike të tyre. Mbështetur në grup-pyetjet për provimin përfundimtar, komisioni i posaçëm, i ngritur nga përgjegjësi i departamentit, harton tezat, prej nga përzgjidhet njëra syresh.</p> <p>EVIDENCA 1.8;</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Referuar RVB-së, GVJ konstaton se personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës, të cilat janë nga fusha e kërkimit shkencor që pedagogu mbulon. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës, sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. Departamenti angazhohet për konsultimet që kryhen në mbështetje të studentëve që do të japin provimin përfundimtar.</p> <p>EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 1.35; EVIDENCA 3.11;</p>

<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se Departamenti i Histori-Gjeografisë, që mbulon ekspeditën mësimore/praktikën në terren (e cila për vitin I zhvillohet në veri, për vitin II në Shqipërinë e mesme dhe për vitin III në jug të vendit), si pjesë e kurrikulës së programit të studimit, e cila në planin mësimor 3-vjeçar për “Bachelor në Histori dhe Gjeografi” për vitin e dytë e të tretë të tij është planifikuar të zhvillohet në dy javët e fundit, asiston studentët jashtë mjediseve të institucionit, në evidentimin e dijeve teorike të marra në tre vitet akademike të këtij programi studimi në aspektin praktik, për fushat bazë të studimit që mbulon ky program. Ekspeditat mësimore zhvillohen të ndryshme për çdo vit studimi.</p> <p>EVIDENCA 1.39; EVIDENCA 1.35; EVIDENCA 3.11;</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e institucionit, GVJ konstaton se në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p> <p>EVIDENCA 1.8;</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ konstaton se më përfundimin e studimeve, UNIEL-i pajis studentin me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.</p> <p>EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 1.16; EVIDENCA 1.29; EVIDENCA 1.30;</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ ju bë me dije se institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet apo konfirmon rast pas rasti informacione për studentin nëse këto informacione kërkohen nga student.</p> <p>EVIDENCA 1.8; EVIDENCA 1.16; EVIDENCA 3.12;</p>

Konkluzione

GVJ konstaton se UNIEL-i ka hartuar rregulloren e studimeve dhe ka miratuar dhe formatin e punimit të diplomës, të cilin e ka publikuar. Njësia bazë ka hartuar rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar, ose për punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome, gjë që është bërë edhe publike. Në fillim të vitit akademik pedagogët i njohin studentët me objektivat e tyre për kërkimin shkencor, me qëllim që të shfrytëzohen si tema punimi. Çdo student përzgjedh pedagogun udhëheqës, në varësi të interesave që shfaq për të studiuar. Pedagogu dhe studenti bashkëpunojnë intensivisht përgjatë vitit akademik, me takime, përmes adresës elektronike, konsultimeve, etj. dhe studentët pajisen me literaturën dhe materialet e nevojshme për të realizuar kërkimin shkencor. Për rastin e provimit final, komisioni i posaçëm për administrimin e tij bazohet mbi testimin e njohurive të dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës së tyre specifike. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës, të cilat janë nga fusha e kërkimit shkencor që pedagogu mbulon. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës, sipas udhëzuesve të miratuar.

Njësia bazë që mbulon ekspeditën mësimore/praktikën në, si pjesë e kurrikulës së programit të studimit, asiston studentët jashtë mjediseve të institucionit, në evidentimin e dijeve teorike të marra në tre vitet akademike të këtij programi studimi në aspektin praktik, për fushat bazë të studimit që mbulon ky program.

Në përfundim të provimit përfundimtar, ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë. Në përfundim të studimeve, UNIEL-i pajis studentin me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. UNIEL-i dhe departamenti i Histori-Gjeografisë ruajnë në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon rast pas rasti informacione për studentin, nëse kërkohen.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1


Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																												
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Të dhënat e institucionit për angazhimin e personelit akademik në programin e studimit Bachelor në “Histori dhe Gjeografi” dëshmojnë se personeli akademik i përfshirë në procesin e mësimdhënies përmbush kërkesat ligjore në fuqi, titujt dhe gradat që zotërojnë tregojnë për një nivel të lartë kualifikimi të nevojshëm dhe të domosdoshëm për këtë program studimi. Referuar (tab 6.1-6.3 te RVB-së), kualifikimi i stafit të angazhuar në mësimdhënie për tre vitet akademike është:</p>																																																												
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Stafi i angazhuar ntafi i angazhuar në mësimdhënie</th> <th colspan="2">Viti akademik 2021-2022</th> <th colspan="2">Viti akademik 2020-2021</th> <th colspan="2">Viti akademik 2019-2020</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Prof. Assoc.</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>5</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr.</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>4</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Msc. (Dr. në proces)</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>7</td> <td>4</td> <td>10</td> <td>4</td> <td>9</td> <td>18</td> </tr> </tbody> </table>						Stafi i angazhuar ntafi i angazhuar në mësimdhënie	Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr.	1	-	2	-	2	3	Prof. Assoc.	3	1	4	-	5	1	Dr.	3	3	4	3	3	6	Msc. (Dr. në proces)	-	-	-	-	-	-	Msc.	-	-	-	1	-	8	Në total	7	4	10	4	9	18
	Stafi i angazhuar ntafi i angazhuar në mësimdhënie	Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020																																																							
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																						
	Prof. Dr.	1	-	2	-	2	3																																																						
	Prof. Assoc.	3	1	4	-	5	1																																																						
	Dr.	3	3	4	3	3	6																																																						
	Msc. (Dr. në proces)	-	-	-	-	-	-																																																						
Msc.	-	-	-	1	-	8																																																							
Në total	7	4	10	4	9	18																																																							
<p>Për vitin akademik 2022-2023, respektohet rregulli që leksionet t'i zhvillojnë vetëm personeli akademik me tituj dhe gradë shkencore. Nga ana tjetër titullarë të lëndës janë personel akademik të kategorisë profesorë dhe lektorë, të angazhuar në mësimdhënie, si PAK, për një periudhë relativisht të gjatë kohe. Nga të dhënat GVJ</p>																																																													

	<p>konstaton se, angazhimi i personelit akademik në module/lëndë është në përputhshmëri me kualifikimet dhe specializimet që ata kanë kryer. Kjo i shërben më së miri studentëve të programit për pajisjen me kompetencave profesionale që në ciklin e parë të studimeve. Kjo u konfirmua edhe në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Dokumentacioni Shtesë: “Shtesa për BA Histori-Gjeografi”;</p> <p>Vizita në institucion;</p> <p>EVIDENCA 4.18; EVIDENCA 4.21; EVIDENCA 4.5;</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dhënë për verifikim konstatohet se:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 ngarkesa mësimore mbulohet 50.5% nga personeli akademik efektiv (PAE) dhe 49,5% nga personeli akademik me kontratë (PAK);</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 ky raport ka ardhur në përmirësim duke rritur ngarkesën mësimore për PAE dhe në vitin akademik 2021-2022 65.2 % e ngarkesës mbulohet nga personeli akademik efektiv (PAE).</p> <p><i>GVJ duke u mbështetur në konstatimet e mësipërme del në përfundimin se nuk është respektuar shpërndarja e ngarkesës mësimore në raportin 70% nga PAE dhe 30% nga PAK, mbështetur në VKM nr. 418, datë 10.05.2017 pika 2 (ii).</i></p> <p><i>Lidhur me këtë GVJ rekomandon jo vetëm rishpërndarje të ngarkesës mësimore në respektim të standardit ligjor por edhe shtim të personelit akademik efektin për plotësimin e nevojave.</i></p> <p>EVIDENCA 4.21; EVIDENCA 4.22; EVIDENCA 4.5;</p> <p>Dokumentacioni Shtesë: “Shtesa për BA Histori-Gjeografi”,</p> <p>Vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>UNIEL nëpërmjet dokumentacionit bashkëshoqërues dëshmon se garanton jo vetëm qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit nëpërmjet kontratave të rregullta të punësimit, por edhe duke kryer pagesat e rregullta të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve njerëzore pranë UNIEL, GVJ konfirmoi nënshkrimin e kontratave të punës për personelin akademik efektiv dhe me kontratë.</p> <p>RVB; EVIDENCA 4.1</p>


<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UNIEL procesin e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik, për zhvillimin e programit të studimit Bachelor në Histori dhe Gjeografi”, e realizon në përputhje me rregulloren e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik të hartuar nga ky institucion, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Referuar Evidencës 4.2 “Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik”; Senati Akademik i UNIEL shprehet me Vendim Nr.24 datë 12.04.2020: “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për punësimin e personelit akademik në UE”. Në këtë vendim renditen:</p> <p>A. Kriteret</p> <p>B. Procedura e rekrutimit e cila kalon sipas fazave të mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> I. Shpallja publike e konkurrimit; II. Kriteret e kualifikimit: <ol style="list-style-type: none"> a. Kriteret të përgjithshme; b. Kriteret te veçanta; III. Procesi i dorëzimit të dokumentacionit; IV. Procesi i vlerësimit të kandidaturave; V. Pikëzimi i dokumentacionit të kandidatëve; VI. Periudha e zhvillimit të procedurave të konkurrimit; VII. Shpallja e fituesit; <p>Bashkëlidhur në vendim paraqitet edhe formulari i aplikimit të konkurrentit. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh nga afër me disa praktika të rekrutimit të cilat ishin konformë procedurave dhe kritereve të sipër përmendura.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB, UNIEL ka një rregullore të modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmës akademik, në të cilën përcaktohen kriteret dhe procedurat e punësimit të personelit ndihmës akademik. EVIDENCA 4.3; Personeli ndihmës akademik realizon orët laboratorike dhe shërben për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore në varësi të natyrës së programit të studimit.</p> <p>Në RVB thuhet që këto pozicione janë të paraqitura në EVIDENCËN 1.10 struktura organizative e UNIEL. Por nga verifikimi që GVJ i bënë dokumentit rezulton se në organigramën e paraqitur skematikisht nuk ka informacion lidhur me personelin ndihmës akademik të angazhuar në këtë program studimi. Edhe në shqyrtimin e dokumentacionit shtesë: Shtesa për BA Histori-Gjeografi në tabelat për angazhimin e stafit akademik në programin e studimit Bachelor në Histori dhe Gjeografi GVJ konstaton se nuk paraqiten të dhëna rreth angazhimit të stafit ndihmës akademik.</p>



<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Mbështetur në EVIDENCA 4.5, EVIDENCA 6.4, EVIDENCA 4.21; Dokumentacioni Shtesë: “Shtesa për BA Histori-Gjeografi”, UNIEL dëshmon se grumbullon, përditëson dhe i ruan të dhënat e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Histori dhe Gjeografi. Të dhënat jepen për tri vitet e fundit akademik, për çdo semestër.</p> <p>GVJ konstaton se informacioni jepet vetëm për personelin akademik dhe personin përgjegjës për programin. <i>Në to mungon informacioni lidhur me angazhimin e personelit ndihmës akademik.</i> E vetmja gjurmë informacioni për prezencën e personelit akademik ndihmës është emri i laborantes në një prej procesverbaleve të mbledhjes së Departamentit të njësisë bazë.</p> <p>Dokumentacioni Shtesë: “Shtesa për BA Histori-Gjeografi”</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nëpërmjet dokumentacionit bashkëshoqërues UNIEL dëshmon për bashkëpunime me institucione të tjera si, institucione homologe brenda dhe jashtë vendit ashtu edhe me institucione lokale, agjenci kombëtare dhe ndërkombëtare në shërbim të mbarëvajtjes së programit të studimit Bachelor në Histori dhe Gjeografi. Në këtë program studimi angazhohen si personel akademik i jashtëm, ekspert nga Prefektura e Elbasanit, Shkolla “Dhaskal Todri”, Universiteti Bedër, Instituti i Monumenteve, ZVA Elbasan, ZVA Tiranë, Universiteti i Europës Juglindore në Maqedoninë e Veriut.</p> <p>Gjithashtu.GVJ konstaton se një ndër bashkëpunimet më të suksesshme ka qenë realizimi për herë të parë i Konferencës Shkencore “Qendrat e banuara të Shqipërisë-gjendja dhe e ardhmja” e parë e këtij lloji në Shqipëri, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave Shqiptare dhe Universitetin “Eqerem Çabej” të Gjirokastrës.</p> <p>EVIDENCA 4.5; EVIDENCA 6.4; EVIDENCA 4.21; EVIDENCA 1.13;</p> <p>Dokumentacioni Shtesë: “Shtesa për BA Histori-Gjeografi”</p>

<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Nga dokumentacioni bashkëshoqërues dëshmohet se në mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës mësimore marrin pjesë si personeli akademik efektiv që është i ngarkuar ashtu edhe punonjësi përgjegjës në institucionin ku zhvillohet praktika mësimore.</p> <p>Praktikat e realizuara në terren mbikëqyren nga një grup lektorësh të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët GVJ ju konfirmua edhe njëherë serioziteti dhe përkushtimi i personelit akademik në përmbushjen e detyrës së mbikëqyrjes gjatë praktikave në terren. EVIDENCA 1.13; EVIDENCA 1.35; EVIDENCA 1.39</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se në përgjithësi kriteret e standardit IV.1 janë të përmbushura. Lidhur me Kriterin 2 të këtij standardi konstatohet mos respektim i shpërndarjes së ngarkesë mësimor në raportin 70% e ngarkesës mësimore duhet të mbulohet nga personeli akademik efektiv dhe 30% nga personeli akademik me kontratë mbështetur në VKM nr. 418, datë 10.05.2017 pika 2 (ii). Për këtë GVJ rekomandon rekrutim të personelit akademik efektiv për të plotësuar nevojat. Gjithashtu në Kriterin 6 mungon informacioni lidhur me angazhimin e personelit ndihmës akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Departamenti i Histori – Gjeografisë zhvillon procesin mësimor në mjediset e FSHH me kapacitet 1715 vende, nga të cilat 7 janë salla leksionesh dhe 9 salla seminaresh. Në dispozicion të programit të studimit janë funksional 3 laboratorë, 6 salla seminaresh, me 256 vende 2 prej të cilave janë të pajisura me projektorë, si dhe sallën e Bibliotekës shkencore.</p> <p>Nga vizita në institucion grupi i GVJ konstaton se mjediset e përshkruara në dokumentacion ishin të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e proceseve akademike. Institucioni ka salla të kapaciteteve të ndryshme të ndara në salla leksionesh dhe seminaresh të cilat plotësojnë realizimin e objektivave mësimorë në funksion të 8 studentëve që ka ky program. Studentët e programit “Histori-Gjeografi” kanë patur në dispozicion një infrastrukturë fizike, didaktike dhe logjistike për përmbushjen e realizimit si të orëve teorike ashtu edhe moduleve specifike.</p> <p>Vizita në institucion; RVB;</p> <p>Dokumentacioni Shtesë: “Shtesa për BA Histori-Gjeografi”</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në UNIEL, mjediset mësimore ku zhvillojnë procesin mësimor studentët e programit Bachelor “Histori dhe Gjeografi” garantonin realizimin e procesit mësimor. Kjo sepse Departamenti i “Histori-Gjeografi” ka në funksion të plotë laboratorin e dedikuar për këtë program, Kabineti i Gjeografisë me kapacitet prej 70 vende dhe Kabineti i trashëgimisë Kulturore me kapacitet 30 vende.</p> <p>Dokumentacioni argumentues që shoqëron RVB-në tregon se, departamenti zotëron një fond të pasur hartash historike e gjeografike, të cilat në lëndë të veçanta luajnë një rol të rëndësishëm didaktik-praktik kanë një rëndësi të madhe dhe përdorim të gjerë, në mënyrë të veçantë në lëndë/module specifike të pjesës së Gjeografisë.</p> <p>GVJ konfirmoi se mjedisi logjistik dhe në veçanti infrastruktura didaktike ishte e aksesueshme në çdo kohë, për studentët dhe stafin akademik. Vizita në institucion;</p> <p>Gjatë vizitës në laboratorin e gjeografisë u njohëm me mënyrën sesi studentët përdornin programin GISS, gjithashtu njohja u thellua edhe me shumëllojshmërinë e hartave dhe instrumenteve të tjera hartografik që përdoren nga personeli akademik dhe studentët në laborator. Për realizimi i detyrave të studentëve të programit HGJ bashkëpunohet edhe me laboratorin e teknologjisë së informacionit, i cili mbështeste fort këtë program studimi.</p>


<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ konfirmon se laboratorët përmbajnë aparatura dhe mjete e nevojshme për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Histori dhe Gjeografi”. Nga vizita në institucion u pa konkretisht programet që zbatoheshin në laboratorët e dedikuar ishin në përputhje me objektivat formues të programit të studimit.</p> <p>EVIDENCA 4.7; RVB; Vizita në institucion;</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se Departamenti i “Histori-Gjeografi ka në funksion të plotë laboratorin e Gjeografisë me kapacitet prej 70 vende dhe Kabineti i trashëgimisë Kulturore me kapacitet 30 vende.</p> <p>EVIDENCA 4.8; EVIDENCA 4.7;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton përmbushjen e të katër kriterëve që përbëjnë këtë standard me dokumentacion të bollshëm dhe me konstatim fizik të fakteve nga vizita në institucion.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve




<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse që u vihet në dispozicion studentëve të programit të studimit Bachelor në “Histori dhe Gjeografi” jepet në gjuhën shqipe. Ajo ekziston si në kopje fizike ashtu edhe në formë të digjitalizuar.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion u njoh nga drejtuesi i njësisë bazë me leksionet dhe librat që përdoren nga studentët dhe që ishin të depozituara në departament nga personeli akademik efektiv dhe me kontrate sipas detyrimeve ligjore. Gjithashtu edhe në vizitën e zhvilluar në bibliotekë e konfirmua gjendja fizike e materialeve mësimore dhe literaturës së rekomanduar për këtë program studimi.</p> <p>EVIDENCA 3.7; EVIDENCA 3.8; RVB; Vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ konstatoi raportime të përditësimeve rreth literaturës dhe botimeve më të fundit që përdoren nga studentët në këtë program studimi. Literatura e përditësuar është më së shumti në lëmin e historisë, ndërsa lidhur me atë të gjeografisë përditësimet janë më të kufizuara. Edhe nga EVIDENCA 3.19 “Blerjet e fundit” vihet re mungesë e titujve në fushën e gjeografisë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që në të ardhmen të bëhen më shumë përpjekje nga ana e institucionit në shpenzimet për blerjen e titujve të rinj veçanërisht në lëmin e gjeografisë.</i></p> <p>EVIDENCA 3.8; EVIDENCA 1.11;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në nivel universiteti, UNIEL vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën Universitare dhe bibliotekat për çdo fakultet. Biblioteka e FSHH garanton të drejtën e çdo studenti për aksesim të bibliotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe ambienteve të mjediseve të brendshme dhe të jashtme të saj. Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë shërbimin e internetit nga mbulimi i të gjithë hapësirës së bibliotekës me rrjetin Ëireless dhe të aksesohen në biblioteka on-line.</p> <p>EVIDENCA 3.7; EVIDENCA 3.8; RVB; Vizita në Bibliotekë</p>


<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar listës së arkivave dhe koleksionit shkencor për shkencat humane në gjuhën shqipe dhe të huaj, Biblioteka Universitare e FSHH disponon një fond prej 4014 titujsh për programin e studimit të cilët janë libra me tematikë historike dhe gjeografie. Ndër to mund të përmendim botimet e Akademisë së Studimeve Albanologjike, botimet e Institutit për Krimet e Komunizmit, Instituti “Lumo Skëndo” Botime të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Kosovës, Instituti i Studimeve Shqiptare e Protestante. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua nga punonjësja e bibliotekës mbi procedurat e pasurimit të fondit të bibliotekës dhe u njoh nga afër me këndin e dedikuar me libra në lëmin e “Histori-Gjeografi”.</p> <p>Evidenca 3021; RVB; Vizita në Bibliotekën e FSHH</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Regjistrimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në bibliotekë është pa pagesë për studentët dhe stafin akademik.</p> <p>RVB; Vizita në institucion (Bibliotekën e FSHH);</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Bibliotekat ishin të pajisura me lidhje interneti dhe poste kompjuterësh të cilët mundësojnë aksesin e studentëve në biblioteka online, në të cilat UNIEL kryen abonim, në: U – library, JSTORE. Studentët krijojnë llogaritë e tyre personale në këto rrjete dhe shfrytëzojnë literaturën e nevojshme sipas profilit kërkimor.</p> <p>Vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të premte. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 8.00-16.00. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje të orareve mësimore. Gjithashtu studentët kishin mundësinë të tërheqin gjithashtu literaturë për shfrytëzim jashtë ambienteve të bibliotekës. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët kishin mundësi të shfrytëzonin bibliotekën gjatë hapësirave të lira kohore dhe të aksesoheshin në biblioteka on-line deri në orarin e mbylljes së saj.</p> <p>RVB; Takimi me punonjësen e bibliotekës</p>

<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Histori dhe Gjeografi” dëshmon se ruan dhe ndjek lidhjen me bibliotekën për cilësinë e titujve të librave në shërbim të programit. Gjatë takimit me drejtuesen e njësisë bazë dhe vizitës në bibliotekë u njohëm me disa nga kartelat e studentëve të cilat dëshmonin për shfrytëzimin e fondit të historisë dhe Gjeografisë.</p> <p>Lidhur me fondin online në gjuhë të huaj u konstatua se titujt e ofruar nga JSTORE dhe U-library janë të vjetër veçanërisht për fushën e gjeografisë, e cila vitet e fundit nje përparime.</p> <p>Për këtë rekomandohet abonimi i institucionit në Google Scholar në mënyrë që kontakti me titujt në gjuhë të huaj dhe të rejtat në lëmin e historisë dhe gjeografisë të vijë më afër studentëve dhe personelit akademik.</p> <p>RVB; EVIDENCA 1.11; Vizita në institucion</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UNIEL vë në dispozicion të programit të studimit literaturën e nevojshme në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme) dhe në këtë kuadër të gjithë kriteret janë të përmbushur. Ajo ç’ka GVJ thekson për standardin IV.3 është përditësimi i literaturës me titujt të rinj, kryesisht në gjuhë të huaj dhe në lëmin e gjeografisë dhe aksesimin me artikuj shkencor më të fundit nëpërmjet abonimit në Google Scholar.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	


<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohen të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UNIEL ka një sistem të menaxhimit të informacionit të quajtur “Sistemi i Menaxhimit në Edukim EMS” të instaluar sipas përcaktimeve të marrëveshjes me RASH. Përmes këtij programi informatik krijohen, shikohen, përditësohen, ruhen, administrohen dhe përpunohen të dhëna të studentit nga regjistrimi deri në diplomim. Sistemi, ndër të tjerash, përmban të dhënat personale të studentit, regjistrimin e notave etj.</p> <p>RVB; EVIDENCA 4.11</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UNIEL përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm që përdor, në bazë të programeve të studimit mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët. Përmes sistemit EMS, institucioni mundëson dokumentacionin dhe komunikimin midis studentëve dhe stafit. Përmes përdorimit në nivel institucional të këtij sistemi realizohet gjithashtu monitorimi në kohë reale i aktivitetit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se format e mbështetjes së sistemit për personelin akademik ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Publikimi online i kurrikulës së programit të studimit; 2. Monitorimi i planit mësimor; 3. Regjistrimi në sistem i personelit akademik përgjegjës për lëndën/modulin dhe atë ndihmës mësimor; 4. Raportimi mbi ecurinë e plotësimit të afateve të përcaktuara në Manual; EVIDENCA 4.11; RVB <p>Format e mbështetjes për studentët ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ngarkimin e detyrave të kursit; 2. Ngarkimin e projekteve; 3. Marrjen e leksioneve të ngarkuara nga personeli akademik; 4. Marrjen e vlerësimeve; <p>Personeli ndihmës akademik ndihmon studentët duke ju vënë në dispozicion një sekretari online në kohë reale dhe nga çdo vend, për t’iu bërë të ditur:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grafikonin e provimeve; 2. Notat e provimeve; 3. Lajmërimi apo informacione të dërguara nga pedagogët apo departamenti; 4. Vërtetime të ndryshme;



<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në UNIEL krahas sistemit EMS është përdoruar e Mikrosoft Team i cili ka krijuar mundësinë e komunikimit interaktiv dhe në kohë reale. Përmes kësaj platforme realizohen shkëmbime të informacionit midis stafit akademik dhe studentëve. Platforma Microsoft Team mundëson monitorimin e aktivitetit akademik nga strukturat e NJSBC-së dhe jo vetëm. Gjithashtu përmes kësaj platforme merren të dhëna dhe realizohen raporte mbi aktivitetin e përdorimit të saj nga anëtarët e personelit akademik.</p> <p>EVIDENCA 6.1; RVB</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të programit të studimit Bachelor në HGJ GVJ konstatoi se sistemi EMS kontrollon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Autenticitetin e informacionit identifikues të përdoruesit; ➤ autorizon aksesin e përdoruesit në të gjitha funksionet/operacionet; ➤ ruan privatësinë e të dhënave; <p>Nëpërmjet këtij sistemi institucioni mund të monitoroj në kohë reale aktivitetin mësimor të personelit akademik dhe administrativ. Gjithashtu me të dhënat reale mund të hartohen raporte monitorimi rreth performancës së procesit mësimor si nga personeli akademik, ndihmës por edhe pjesëmarrjes së studentëve në frekuentimin dhe zhvillimin e procesit mësimor. Të dhënat e grumbulluara iu vihen në dispozicion titullarëve të njësisë kryesore por edhe të njësisë bazë. Nga këto të dhëna krijohet një panoramë e qartë rreth hedhjes në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e kriterëve të vlerësimit dhe respektimin e afateve të hedhjes së rezultateve online. Sistemi EMS ka aksesin e tij nga faqja zyrtare e internetit të UNIEL. Linku për aksesim në sistemin EMS</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ provoi të hynte në faqen e internetit të UNIEL dhe konfirmoj informacionin e kërkuar lidhur me gjuhën e hedhjes së informacionit në internet.</p> <p>https://www.uniel.al/</p>




Konkluzione	<i>UNIEL disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional si EMS-ja dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Të gjithë kriteret janë të arsyetuar nëpërmjet një dokumentacioni të verifikueshëm dhe mbështetës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ bazuar në RVB konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni gjatë muajit tetor të çdo viti. UNIEL nëpërmjet Drejtorisë së Financave dhe Drejtorisë Ekonomike harton raportin vjetor të veprimtarisë financiare të UNIEL në të cilin përfshihet raporti financiar i kostove të programeve të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi.

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Mbështetur në RVB burimet e financimit të UNIEL janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> A. Transferta nga Buxheti i Shtetit; B. Tarifa vjetore e studentëve për arsimim; C. Donacione dhe burime të tjera financimi; D. Të ardhura të akumuluar për shërbimet e ofruara; E. Të ardhura të gjeneruara nga marrëdhëniet me palët e treta; F. Të ardhura nga organizimi i veprimtarive kërkimore – shkencore;[RVB] <p>Përgjegjësi i njësisë që mbulon programin e studimit bënë planin e financimit të një program studimi, etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për planin e financimit të një program studimi nga UNIEL rezulton të jetë një dokument me emërtim “Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi” i hartuar nga Rektorati. Në dokument jepet informacion rreth sipërfaqes së mjediseve për student, kosto e përgjithshme e studimeve dhe tarifa e shkollimit për ciklin e studimeve Bachelor. Në këtë dokument sqarohet formula e përlllogaritjes së koston për një student. Për vitin akademik 2022-2023 kostoja e përgjithshme e studimeve për një student në FSHH, të ciklit Bachelor është përlllogaritur të jetë 196, 261 lekë.</p> <p>Ndërkohë tarifat e shkollimit nuk janë vendosur referuar koston përlllogaritur por shumë të ulta. Tarifa e shkollimit për një student të ciklit të parë është në vlerën 25,000 lekë për program të parë studimi dhe 60,000 lekë për program të dytë studimi. EVIDENCA 4.16; RVB</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në RVB, UNIEL ka raporte auditimi çdo vit. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Ky raport paraqitet prej administratorit të universitetit pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.</p> <p>EVIDENCA 4.13; EVIDENCA 4.16; EVIDENCA 6.2</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi</p>	<p>Institucioni raporton në njësinë bazë mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit pasardhës. Anëtarët e DHGJ njihen me buxhetin e miratuar të vitit pasardhës. RVB</p> <p>GVJ e konfirmon këtë edhe në takimin me personelin akademik gjatë vizitës në institucion.</p>



realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.									
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	<p>UNIEL si institucion publik i arsimit të lartë i siguron burimet e financimit nga:</p> <p>A. Granti që akordohet nga MAS;</p> <p>B. Të ardhurat që siguron institucioni nga vjelja e tarifave të regjistrimit, tarifat e shkollimit, si dhe të ardhura nga shërbime të tjera që ofron institucioni;</p> <p>Qëndrueshmëria financiare e UNIEL garantohej nga fondi i pakushtëzuar që akordon MAS dhe tarifat e regjistrimit. [RVB]</p> <p>GVJ, bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me përfaqësues të GVB dhe Stafin Akademik, u informua se politika e mbështetjes mundësohet nga qëndrueshmëria financiare dhe forma e menaxhimit të qendëruar duke mundësuar shpërndarjen e kostove në nivel institucion. Takimi në institucion</p>								
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se standardi IV.5 përmbushet në të gjithë kriteret. UNIEL garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.

Institucioni ka një kuadër të plotë të hartimit dhe zbatimit të procedurave për zhvillimin e aktivitetit akademik si: Statut, Rregullore Universitetit, Strategji, Vendimet e Senatit Akademik, Rregullore e FSHH, Rregullore e Programit të studimit e të cilat dëshmojnë për procedurën, duke filluar nga miratimi i kuotave të pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes dhe procesin e pranimit të studentëve. Në dokumentin Rregullore e studimeve në UNIEL bëhet e qartë politika që ndjek institucioni dhe kriteret e pranimit për të tre ciklet e studimit që ofron ky universitet. GVJ konstatoi se politikat e ndjekura në institucion janë konformë legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të universitetit.


EVIDENCA 1.2; EVIDENCA 1.22; EVIDENCA 1.23; RVB

Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar GVJ konstatoi se që në hyrje të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si; **kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtari akademike, kulturore, njoftime.** Gjatë vizitës në institucion, në takimim me studentët edhe përfaqësuesit e Qendrës së Karrierës dhe Alumni, GVJ u njoh me format e informimit që ishin:



1. Veprimtari informuese që organizon vetë departamenti;
2. Informim nga pedagogët;
3. Informim nga strukturat administrative në Rektorat;
4. Informacioni i marrë në sistemin EMS;

Të gjitha format e renditura u japin mundësi të barabartë të gjithë studentëve për të qenë të informuar. Gjithashtu mundësi të barabartë iu ofrohet edhe kandidatëve për student në këtë universitet nëpërmjet shpalljes së detyrueshme të listës së studentëve fitues në programin e studimit në stendën e njoftimeve të universitetit edhe në faqen zyrtare të UNIEL. Nga verifikimi GVJ konstatoi se listat e fitueseve ishin të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.


Në dokumentacionin e shqyrtuar si Statuti i UNIEL, Rregullore e UNIEL dhe dokumente të tjerë, vërehet që kriteret dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes janë të kuptueshme dhe të aksesueshme. Studentët kanë mundësi që të aksesojnë kriteret e pranimit dhe të njohin procedurat qoftë nëpërmjet sistemit EMS, takimeve informuese, broshurave dhe nëpërmjet faqes zyrtare të UNIEL dhe të Qendrës së Karrierës dhe Alumnit.



<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret specifike (nëse ka) propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Senati Akademik. Ky informacion është i aksesueshëm pasi publikohet në faqen zyrtare të universitetit. Gjithashtu nga dokumentacioni verifikojmë se DHGJ planifikon regjistrimin e studentëve të huaj dhe studentëve nga trojet shqiptare.</p> <p>Student të planifikuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. 1 kuotë për student të huaj; 2. 5 kuota për student nga Kosova; 3. 5 kuota për student nga Maqedonia e Veriut; <p>EVIDENCA 1.2; EVIDENCA 1.22; EVIDENCA 1.23</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Njohja me kriteret e procedurat e pranimit, transferimet e studentëve dhe njohja e studimeve të mëparshme janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku kjo sepse ato sipas akteve ligjore bëhen publike dhe shpallen në faqen zyrtare të institucionit UNIEL dhe po ashtu nga agjencitë shtetërore të QSHA dhe RASH. GVJ konstatoi hedhjen e këtij informacioni në faqen zyrtare të UNIEL. Ndërsa lidhur me transparencën dhe kuptueshmërinë e përparimit të studentëve gjatë zhvillimit të kursit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit ato janë të aksesueshme nëpërmjet organizimit dhe funksionimit të Sistemit të Menaxhimit në Edukim të UNIEL (EMS). Gjatë vizitës në institucion GVJ mundi të hynte në sistemin EMS dhe verifikoi funksionimin e tij.</p> <p>EVIDENCA 1.2; EVIDENCA 1.22; EVIDENCA 1.23; RVB</p>

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka disa forma të informimit dhe orientimit mbi kërkesat e kriteret që ka programi i studimit si: takimet informuese në institucion; përdorimi i faqes zyrtare; rrjeteve sociale etj.</p> <p>EVIDENCA 1.2; EVIDENCA 1.22; EVIDENCA 1.23; RVB</p> <p>[Referoju Kriterit 2 dhe 3 të këtij standardi]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Nuk ka dokument</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>DHGJ harton planifikime për përzgjedhjen e kandidatëve nga Trojet Shqiptare dhe shtetas të huaj por nuk ka informacion nëse harton kriteret specifike për pranimin e këtyre kategorive.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni bashkëshoqërues konstaton se UNIEL harton politika për aplikimin e bursave për shtresa në nevojë. Kështu Bordit i Administrimit të UNIEL në vendimin Nr.38, datë 02.11.2021 “Për procedurën e aplikimit të studentëve të Ciklit të Parë të studimit, dhe program të parë studimi që përfitojnë bursa financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, si student të shkëlqyer dhe student me kriteret të tjera” dëshmon për kriteret të tjera por nuk shprehet nëse këto kriteret të tjera përfshijnë bursa për shtresat në nevojë.</p> <p>EVIDENCA 2.1; RVB</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni harton, ndjek, zbaton politika e procedura për pranimin, transferimin, njohjen, vlerësimi dhe diplomimin e studentëve të programit të studimit Bachelor në HGJ. Përgjithësisht kriteret e këtij standardi rezultojnë të përmbushura, përveç kriterëve të përzgjedhjes së studentëve me aftësi të kufizuara dhe studentëve të huaj.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregulloreve të fakultetit, të studimeve dhe dokumentacionit shoqërues studentet marrin informacion të hollësishëm rreth:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Frekuentimit. Frekuentimi i leksioneve është fakultativ ndërsa frekuentimi i seminareve dhe ushtrimeve (për të cilën student informohet për masën 75% të frekuentimit të detyrueshëm, frekuentim e detyrueshëm të punëve të laboratorit në masën 100%, projektet duhen të shlyen në masën 100%, në të kundërt student nuk hyn në provim); 2. Organizimi i praktikave profesionale; 3. Kushtet e kalimit në vitin pasardhës; 4. Pezullimi i studimeve; 5. Kontrolli i dijeve dhe Vlerësimi <ol style="list-style-type: none"> a. Instrumentet e vlerësimit (testime / me shkrim / me gojë / projekte / prezantime / praktika / teza e diplomës); b. Format e kontrollit të dijeve; c. Sistemi i vlerësimit; d. Afatet e provimeve; e. Kushtet për hyrjen në provim; f. Mënyra e zhvillimit të provimit; g. korrigjimit të gabimit material të notës; g. Ankimit <p>GVJ konstatoi që rregullorja është edhe në faqen zyrtare të institucionit. EVIDENCA 1.7</p>



<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni ka një rregullore të studimeve në të cilën jepen qartë hapat për procesin mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin ku bazohet realizimi i procedurës dhe informim i studentëve mbi këto procese. Gjithashtu Zyra ndaj Kujdesit të studentit të studentit në bashkëpunim me Departamentin dhe Sekretarinë Mësimore informojnë dhe lehtësojnë studentin me vlerësime paraprake për transferim studimesh apo njohje të tyre. Studentët mund të aksesojnë informacionin lidhur me procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose të pjesshme nëpërmjet faqes së ëeb-it të UNIEL. GVJ konstatoi që rregullorja është edhe në faqen zyrtare të institucionit. EVIDENCA 1.7; RVB</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informimi i studentëve lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve realizohet në disa forma:</p> <ul style="list-style-type: none"> A. Npërmjet rregulloreve të programit të studimit; B. Npërmjet praktikës së informimit të studentëve të viti të parë të programit HGJ; C. Npërmjet syllabus-eve lëndore që jepen nga personeli akademik në orën e parë të fillimit të çdo lënde; D. Npërmjet personelit akademik në fillim të çdo semestri; E. Rregullorja e programit të studimit dhe syllabus-et aksesohen online nga studentët; <p>GVJ konstaton se informimi i studentëve lidhur me procedurat e vlerësimit është i larmishëm dhe i shtrirë në disa plane. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me student në ditët e vizitës në institucion. EVIDENCA 1.7</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Departamenti HGJ në FHF ka hartuar një udhëzues për punimin e diplomës, të cilin e bënë të njohur për studentët në seanca informimi të dedikuara për këtë qëllim. Personeli akademik dhe përgjegjësi i departamenti i njohin studentët me këtë udhëzues të shpërndarë në rrugë elektronike. [RVB], [Shtojca 2.2 – Rregullore e FEF, Kreu VI 174 Shtojca 2.5 – Rregullore e programit të studimit, Mbi punimin e diplomës/disertacionit; Takimi me GVB; Takimi me Studentët]</p> <p>Gjatë takimit në institucion GVJ konfirmoi informacionin e marrë nga RVB dhe nga takimi me anëtarët e GVB dhe nga takimi me studentët për zbatimin konkret të këtij procesi. Por gjurmë të këtij procesi nuk kemi.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB-së dhe takimi me stafin akademik rezulton se institucioni organizon në fillim të vitit akademik “Javën e orientimit”. Përgjatë javëve të regjistrimit, institucioni vendos grupe pedagogesh për të informuar studentët e interesuar.</p>



<p>publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Gjithashtu mbledhjet e departamentit janë të hapura për studentët e interesuar. Përgjatë javëve të regjistrimit, institucioni vendos grupe pedagogesh për të informuar studentët e interesuar. Gjithashtu mbledhjet e departamentit janë të hapura për studentët e interesuar.</p> <p>Vizita në institucion, Takimi me studentët;</p> <p>GVJ e konfirmoi informacionin për zhvillimin e javës së orientimi dhe pajisjen me udhëzuesin edhe nga takimet që zhvilloi me studentët e programit të studimit Bachelor në HGJ, gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu student u shprehën të kënaqur nga puna promovuese e anëtarëve të personeli akademik të DHGJ. Përgjatë javëve të regjistrimit, institucioni angazhon grupe personel akademik për të informuar studentët e interesuar. Gjithashtu mbledhjet e departamentit janë të hapura për studentët e interesuar.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton përmbushjen e të gjithë kriterëve që lidhen me vënien në dispozicion të studentëve të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Histori dhe Gjeografi". Informacion i dhënë nga UNIEL dhe DP HGJ është i plotë e i hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>


<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka disa forma të informimit të studentëve për sa i takon njohjes me strukturën dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Njëpërmjet sesionit informues që realizohet në fillim të ciklit të parë të studimit; 2. Njëpërmjet rregullores së programit të studimit; 3. Njëpërmjet syllabus-eve lëndore; 4. Njëpërmjet personelit akademik të departamentit të HGJ.; Njëpërmjet afishimeve në këndin e njoftimeve në hollin e FSHH; 5. Në monitorët e vendosur në mjediset e Fakultetit FSHH ku zhvillohet program i studimit HGJ;

	[RVB; Vizita në Institucion]
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Që në momentin e regjistrimit, studenti pajiset me programin e studimit që përmban lëndët dhe modulet e tij. Institucioni siguron akses dhe informacion për studentët në lidhje me elementët e programit të studimit që ata ndjekin përmes sistemit EMS dhe stafit akademik që realizon programin. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Institucioni kontrollon marrjen apo jo të informacionit nga studentët për modulet, lëndët, metodën e vlerësimit dhe detyrat që do të zhvillohen gjatë kursit, nëpërmjet pyetësorëve që i realizon në fund të çdo semestri.</p> <p>Kjo vlerësohet si një punë shumë e mirë që bëhet nga ana e institucionit për vrojtimin në mënyrë sistematike të masës me të cilën përmbushet marrja e informacionit nga studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Institucioni organizon panairë të tregut të punës si dhe ka strukturën e bordit të tregut të punës që mundëson lidhjen e studentëve të punësuar me universitetit. Gjithashtu zyra e QKA bënë njoftime për mundësi punësimi.</p> <p>EVIDENCA 5.5; EVIDENCA 5.6; RVB; Takimi me përfaqësues të Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimet e realizuara u informuam mbi sistemin dhe strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Institucioni, përmes koordinatorit të programit të studimit mban komunikim dhe informonte studentët për njoftimet që lidheshin me procesin mësimor. Gjithashtu njoftimet vendoseshin dhe në këndin e njoftimeve. Njoftimi realizohej dhe në rrugë elektronike përmes postes elektronike të studentit apo sistemit EMS.</p> <p>Vizita në Institucion, takimi me studentë; RVB;</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në institucion informacioni në lidhje me dhe kuptueshmërinë e përparimit të studentëve gjatë zhvillimit të kursit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit për programin e studimit Bachelor në HGJ mundësohet nëpërmjet organizimit dhe funksionimit të Sistemit të Menaxhimit në Edukim të UNIEL (EMS). GVJ nga vizita në institucion u njoh nga afër dhe pa 5 spotet elektronike të vendosura në hollin e fakultetit, nëpërmjet të cilave studentët mund të merrnin në kohë reale informacionin e kërkuar përmes këtij sistemi.</p> <p>RVB; Vizita në institucion; EVIDENCA 4.11</p>

Konkluzione	<i>GVJ konstaton përmbushjen e të gjithë kriterëve lidhur me vënien në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit, nga ana e UNIEL për programin Bachelor në HGJ..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pa fizikisht dokumentacionin që lidhej me statistikat vjetore për numrin e studentëve të diplomuar në Bachelor “Histori-Gjeografi”. Dokumentacioni bazë konsiston në regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistri i lëshimit të diplomës.</p> <p>Mbështetur në (Tabelen 21 të RVB) dhe vizitës në institucion rezulton se numri i studentëve për tre vite akademike është:</p> <p>2020-2021 6 studentë;</p> <p>2021-2022 0 studentë;</p> <p>2022-2023 8 studentë;</p> <p>Takimi në sekretarinë mësimore; RVB</p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ iu vu në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, ata që ishin çregjistruar dhe ata që ishin me status aktiv.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna vjetore për programin Bachelor “Histori-Gjeografi”. Gjithashtu përmes sistemit EMS institucioni i disponon statistikat në çdo kohë.</p> <p>Takimi në sekretarinë mësimore; RVB;</p>



<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se, të dhënat për studentët si regjistrimet, vlerësimet e cdo lënde, detyrimet akademike të studentëve, mbahen manualisht si dhe në mënyrë elektronike në sistemin e informacionit EMS, nga sekretaria, sipas procedurave që parashikohen në statutin e UNIEL dhe në rregulloren e UNIEL.</p> <p>Këto forma të kombinuara të mbajtjes së të dhënave, fizikisht dhe elektronikisht, GVJ i vlerëson pozitivisht, sepse rrisin sigurinë e ruajtjes së të dhënave, por edhe shpejtësinë e sigurimit të informacionit nga përdoruesit e autorizuar të sistemit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Sistemi EMS bënë të mundur krijimin shikimin dhe përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave për veprimtarinë e personelit akademik të UNIEL, studentëve dhe personelit ndihmës akademik. Nga të dhënat që gjeneron ky sistem strukturat në nivel drejtimi kryejnë vlerësime dhe kontrollojnë saktësinë e informacionit. Vlerësimi iu përcillet departamenteve, dekanateve dhe rektoratit për veprime të mëtejshme. Krahas sistemit të menaxhimit të brendshëm UNIEL menaxhon të dhënat statistikore të edhe përmes sekretarisë mësimore e cila ka të dhënat personale të studentëve, numrin e telefonit, adresat e email-it, dhe ruan kontaktet me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti ruhen nga sistemi në mënyrë diskrete dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat TI-it të autorizuar në fakultet dhe rektorat.</p> <p>EVIDENCA 4.11; EVIDENCA 1.16</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Për programin e Studimit Bachelor “Histori-Gjeografi”, departamenti ka realizuar një analizë mbi arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Ky dokument analizon komponent të ndryshëm të këtij programi studimi.</p> <p>GVJ e konfirmoi hartimin e raporteve si nëpërmjet dokumenteve ashtu edhe në takimin me përgjegjësën e njësisë bazë të programit të studimit dhe takimin me personelin akademik.</p> <p>EVIDENCA 1.11; EVIDENCA 4.19; EVIDENCA 1.34; EVIDENCA 1.33</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se standardi V.4 përmbushet plotësisht. Kriteret lidhur me vlerësimin e administrimit, përditësimin dhe ruajtjes së të dhënave të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre janë të justifikuar me dokumentacion të bollshëm mbështetës dhe argumentues.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UNIEL, studentët përfshihen në disa struktura drejtuese me karakter mësimor-kërkimor dhe shërbime. Përfaqësuesit e studentëve përfshihen në struktura si:</p> <ul style="list-style-type: none"> A. 1 student në Bordin e Administrimit; B. 2 studentë në Senat Akademik; C. Këshilli i Studentëve; D. Këshillat e Studentëve në nivel njësie kryesore; E. 1 student në Këshillin e Etikës; F. 1 student në NJSBC; G. Komisioni I Përhershëm i për Standardet e Cilësisë; H. Komisioni I Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e karrierës; <p>Dokumentacioni shoqërues tregon se UNIEL është në zbatueshmëri të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në Senatin Akademi, në Bordin e Administrimit, në Komisionin e Etikës, në komisionet zgjedhore, në zgjedhjet për Rektorin e universitetit dhe Dekanin e Fakultetit.</p>

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.

Krahas detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e UNIEL, institucioni përdor disa forma të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik përmes pyetësorësh në përfundim të çdo semestri. Nga shqyrtimi i disa modeleve pyetësorësh GVJ konstaton se studentëve Ju kërkohet të vlerësojnë sipas rubrikave:

Lëndët e zhvilluara:

1. Lëndë të përshtatshme për programin e studimit
2. Lëndë të vështira
3. Lëndë të papërshtatshme për programin e studimit.
4. Lëndë që ju aftësojnë praktikisht
5. Lëndë që përmbajnë informacion bashkëkohor

Realizimin e orëve:

- A. Realizimi i leksioneve
- B. Seminareve
- C. Diskutimeve

Vlerësimin e performancës së personelit akademik:

1. Përdorimin e metodave
2. Motivimin e studentëve
3. Vlerësimin e studentëve
4. Respektin ndaj studentëve

Vlerësimin e materialeve mësimore:

- Materialet mësimore janë të përshtatshme për lëndën
- Biblioteka është e pasur
- Interneti përdoret në funksion të mësimin
- Teknologjia mësimore përdoret në funksion të mësimin

Pyetësi studentor hartohet në bashkëpunim midis sektorit të kurikulave dhe sigurimit të cilësisë dhe NJSBC-së. Pyetësi siguron anonimat e studentit. GVJ konstaton se institucioni jo vetëm që përfshin student në procesin e vlerësimit por vjel mendimin e tyre në çdo aspekt të procesit mësimor dhe infrastrukturës mësimore. Informacioni i grumbulluar është i bollshëm për të hartuar raporte të cilat analizojnë rezultatet e këtyre instrumenteve në nivel të strukturave drejtuese.

EVIDENCA 1.40; EVIDENCA 5.15;

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të


Përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit në bazë të rregullt vihet re në, realizimin e pyetësorit që iu bëhet studentëve në fund të çdo semestri. Në këtë pyetësor, ka një rubrikë e cila titullohet "Lëndët e zhvilluara". Në

<p>studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>këtë rubrikë studentët nëpërmjet pyetjeve të shtruara në pyetësor japin mendimet e tyre lidhur me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Qartësinë e objektivave lëndorë; 2. Strukturimin e lëndëve të programit; 3. Lëndë të papërshtatshme për programin e studimit; 4. Masa e plotësimit të pritshmërive profesionale nga lëndët e ofruara; 5. Mjete, teknikat dhe modat e përdorura në mësimdhënie 6. Lëndë që ju aftësojnë praktikisht <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë që përmbajnë informacion bashkëkohor; <p>GVJ në takimin online me Drejtuesin e Departamentit u theksua rëndësia dhe vlera e përfshirjes së studentëve në procesin e vlerësimit të procesit akademik si dhe realizimi i mbledhjeve të departamentit në formatin e hapur ku ftohen dhe studentët.</p> <p>EVIDENCA 5.15; Takimi me drejtuesin e njësisë bazë të HGJ;</p>		
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët si dhe nga këqyrja e dokumentacionit vërehet se studentëve u mundësohet transparenca dhe barazia në marrjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në Rregulloren e Universitetit, përcaktohet procedura në rast ankese nga studenti. Sipas kësaj procedure, studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës në tezë. Drejtuesi i njësisë bazë ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë drejtuesi i njësisë, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar...etj.</p> <p>EVIDENCA 1.2; EVIDENCA 1.4; EVIDENCA 1.14; EVIDENCA 1.8</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni përfshihet dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre duke u mbështetur në dokumentacion të bollshëm argumentues.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Njësia e posaçme që kryen informimin është zyra e informimit pranë FEF dhe sekretaria mësimore, të cilat ofrojnë shërbim ditore të nevojave për shërbime nga ana e studentëve. Krahas tyre edhe Zyra e KKA ofron shërbime për të gjitha kërkesat, paqartësitë, procesin e këshillimit, informimit dhe ndjekjen e studentëve.</p> <p>Sistemi i online EMS luan rolin e sekretarisë online. Ai bënë të mundur përmbushjen e të gjitha detyrimeve të procesit mësimor të parashikuara në rregulloren e UNIEL-it.</p> <p>Edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore dhe zyrën e informimit të FSHH u vu re nga GVJ që informimi i studentëve kryhej në përputhje me aktet rregullatore të UNIEL.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Rolin e njësisë për këshillimin e karrierës e luan Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni e cila zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të UNIEL.</p> <p>Format e shërbimit që KKA ofron për studentë janë Informimi dhe Orientimi profesional, siç është informimi për praktika profesionale. Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit Histori-Gjeografi mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale në institucionet arsimore lokale dhe në bashkëpunim me Bordin e Biznesit. Njëherazi prej studentëve morën vlerësime rreth cilësisë së shërbimit prej kësaj njësie.</p> <p>Takimet me student; EVIDENCA 5.16;EVIDENCA 5.17; EVIDENCA 5.16; Takimet me përfaqësues të KKA</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit</p>	<p>Qendra për Këshillim Studentor u ofron studentëve informacion dhe orientim të posaçëm për procesin mësimor, praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>RVB; EVIDENCA 5.6;</p>



mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.									
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Raportet e gjurmimit të studentëve tregojnë për një procedurë të rregullt dhe sistematike të mbajtjes së kontakteve me studentët Alumni. Raportet gjithashtu tregojnë se procesi i gjurmimit të studentëve kryehet si nëpërmjet email-ve personale, telefonatave dhe faqes së zyrës së KKA. RVB; EVIDENCA 5.6; EVIDENCA 5.16;EVIDENCA 5.17;								
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Për këtë arsye standarti përmbushet plotësisht</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Në RVB-në e programin e studimit, përmbushja e këtij kriteri lidhet më së shumti me manualin e mësimit në distancë, manual ky që u përdor gjatë periudhës së pandemisë në kushtet e distancimit social, gjë e cila dëshmohet edhe nëpërmjet evidencës 6.1 “Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams”;</p> <p>Në takimin me personelin akademik të brendshëm dhe të jashtëm që kontribuon në zhvillimin e programit, GVJ morri dijeni se, mungesa e një udhëzuesi në nivel institucional për zhvillimin e metodave inovative në mësimdhënie argumentohet me përvojën e gjatë dhe kontributive në fushën e mësimdhënies dhe traditës dhjetravjeçare që ky institucion ka dhe kontributit që ai ka dhënë në themelet e arsimit shqiptar.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>NJSBC në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë kryejnë në mënyrë periodike për periudhën e tri viteve të fundit ka kryer vlerësime periodike të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik mësimdhënës dhe ndihmës akademik. EVIDENCA 1.4.;</p> <p>Instrumenti që përdoret është pyetësi i miratuar nga Komisioni i Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Të Institucionit dhe Programeve të Studimit. EVIDENCA 6.2</p> <p><i>GVJ konstaton se, NJSBC nuk ka një rregullore të njësisë për të dëshmuar detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj njësie, për këtë rekomandohet që në të ardhmen institucioni duhet të angazhohet për hartimin e saj.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në takimin me përfaqësues të NJSBC në UNIEL dhe takimin me GVB, konkretisht, studentin që ishte pjesë e grupit të punës, u theksua realizimi dhe pjesëmarrjen e aktorëve të jashtëm në funksion të përmirësimit të cilësisë.</p> <p>EVIDENCA 6.2; EVIDENCA 1.4.; EVIDENCA 5.9; EVIDENCA 5.10</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC në UNIEL ka bërë publike pyetësin sipas përmbajtjes dhe përpilimin e të dhënave të grumbulluara nga ky pyetësor. Në përfundim ka hartuar dhe raportin përfundimtar të gjetjeve të cilin ua bëjnë me dije njësisë kryesore dhe këto të fundit njësisë bazë deri tek personeli akademik. GVJ këtë e verifikoi edhe nga takimi me personelin akademik të brendshëm dhe të jashtëm të programit të studimit, gjatë vizitës në institucion.</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>NJSBC harton një raport mbi rezultatet e vlerësimit në të cilin evidenton mangësitë dhe problematikat e dala por, nuk i detajon të dhënat në nivel fakulteti apo program studimi. Në raport nuk përmenden arritjet e aq më pak të lidhen konkretisht me personelin akademik që i përfaqëson këto arritje.</p> <p><i>GVJ rekomandon që në të ardhmen të vihet theksi në promovimin e personelit akademik që ka performuar cilësisht në programin e studimit me qëllim demonstrimin e praktikave më të mira dhe krijimin e standardeve cilësore në mësimdhënie.</i></p> <p>EVIDENCA 6.2; RVB;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UNIEL ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet NJSBCS dhe KPGSC, të cilat janë njësitë përgjegjëse. NJSBC harton pyetësor, kryen proces anketimi për monitorimin e metodave të mësimdhënies, nxjerr rezultate dhe harton raporte bazuar në gjetje. Raporti publikohet në faqen e ëeb-it të UNIEL.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që, përvojën e gjatë dhe frytdhënëse që UNIEL ka në lëmin e mësimdhënies ta përmbledhë në një dokument, i cili të shërbejë si manual i metodave më të mira të mësimdhënies.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në zbatim të Nenit 103 të LAL Nr.80/2015 për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, UNIEL dëshmon për ekzistencën e politikave të sigurimit të brendshëm të cilësisë në dokumentet si, statut, rregullore dhe strategji.</p> <p>Ai ka politika dhe procedura të qarta për sa i takon sigurimit të cilësisë. Struktura përgjegjëse NJSBC, programon punën në bazë të strategjisë/manualit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, dhe planit të veprimit të përvitshëm. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, procedurat periodike që përdor për të siguruar cilësinë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i raporteve periodike të vlerësimit të brendshëm; - Realizimi i procesit të matjes së perceptimit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, nga ana e NJBSC-së, për çdo program studimi, në fund të çdo semestri; - Realizimi i pyetësorëve me studentët nga pedagogët e lëndës, në përfundim të çdo semestri me qëllim vlerësimin e performancës së pedagogut nga ana e studentëve; - Hartimi dhe realizimi i analizës së punës mësimore-kërkimore në nivel departamenti dhe fakulteti; <p>Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese të njëjësive bazë.</p> <p>EVIDENCA 1.1; EVIDENCA 1.7; EVIDENCA 1.10;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Dokumentacioni shoqërues dëshmon se në nivel institucional është krijuar dhe funksionon Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo drejtori përbëhet nga sektori i Njësia e Kurrikulave e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë UNIEL dhe sektori i IT. Pranë çdo fakultet janë ngritur dhe funksionojnë Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në këto komisione ka një përfaqësues nga studentët. Në strategjinë e zhvillimit institucional 2020.2024 zhvillimi i kurrikulave është një prej pesë objektivave kryesorë të targetuar.</p> <p>EVIDENCA 1.1; EVIDENCA 1.3; EVIDENCA 1.7; EVIDENCA 1.10; EVIDENCA 5.13;</p>


<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se instrumenti që përdor institucioni për sigurimin e cilësisë është pyetësori institucional për vlerësimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Ky pyetësor kryhet dy herë në vit në fund të çdo semestri. Struktura e pyetësorit është e ndërtuar nga disa rubrika që përmbledhin një set pyetjesh:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Stukturën e përmbajtjen e programit mësimor; - Objektivat lëndorë dhe literaturën; - Performanca e personelit akademik; - Angazhimi i studentëve dhe përmbushjen e detyrimeve; - Vlerësimin për infrastrukturën dhe logjistikën në procesin mësimor; <p>Gjithashtu, instrumente të tjerë për matjen e cilësisë është edhe anketimi nga vetë personeli akademik. Këtë ata e kryejnë në përfundim të çdo semestri për lëndët përkatëse. Qëllimi është që të matin shkallën e përmbushjes së objektivave lëndorë dhe metodologjive të mësimdhënies që ata kanë zbatuar, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e cilësisë kohë pas kohe.</p> <p>Standardet për sigurimin e cilësisë në UNIEL janë në përputhje me Kodin e Cilësisë, hartuar nga ASCAL dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Procesi i sigurimit të brendshëm të cilësisë gërshetohet edhe me sigurimin e jashtëm të cilësisë në bashkëpunim me ASCAL. Më parë institucioni ka kryer dy akreditime institucionale prej të cilëve është vlerësuar maksimalisht. GVJ nga takimi me përfaqësuesin e NJSBC e konsideron akreditimin si një urë bashkëpunimi nëpërmjet të cilit mundësojnë përmirësimin e punës në hartimin e kurrikulave dhe procesin mësimor.</p> <p>EVIDENCA 1.40; EVIDENCA 1.6</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>NJSBC në konsultim me drejtuesit e njësisve bazë në njësitë kryesore harton pyetësorin institucional dhe rubrikat përkatëse për matjen e perceptimit në përputhje me objektivat e përcaktuar më parë. Pyetjet janë të qarta dhe kërkojnë informacion kryesisht për elementët e mësimdhënies dhe më pak për kërkim shkencor. Rezultatet e vlerësimit evidentojnë mangësitë dhe problematikat e dala por, raporti nuk i detajon të dhënat në nivel fakulteti apo programe studimi. Në raport nuk përmenden arritjet e aq më pak të lidhen konkretisht me personelin akademik që i përfaqëson këto arritje.</p> <p><i>Lidhur me këtë <u>GVJ rekomandon</u> që në raport duhet të jetë i planifikuar dhe realizuar për programin e studimit BCH në HGJ. Në raport krahas mangësive të nënvizohen edhe arritjet e spikatura të personelit akademik me qëllim promovimin e tyre.</i></p>

	EVIDENCA 6.2; RVB			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni harton dhe zbaton politika transparente për sigurimin e cilësisë së programit dhe funksionon në përmbushje të kriterëve përkatëse. Në të ardhmen rekomandohet të vihet më tepër theksi në promovimin e personelit akademik që spikat në arritje.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të suajtura të të nxënit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni si në nivel makro ashtu edhe në nivel njësie bazë (Departamenti i Histori-Gjeografisë) dëshmojnë se kanë dokumente formale në të cilat merren në shqyrtim dhe mbikëqyrjen arritjet, dobësitë dhe përcaktohen e planifikohen veprime konkrete për përmirësimin e punës të programit të studimit si, analiza vjetore të UNIEL dhe Departamentit HGJ për periudhën 2020-2021, 2021-2022, strategjia e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në Histori dhe Gjeografi 2020.2024, procesverbale të mbledhjeve të njësisë bazë me personelin akademik të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <p>EVIDENCA 1.17; EVIDENCA 1.18; EVIDENCA 1.34;</p> <p>Dokumentacioni Shtesë: “Shtesa për BA Histori-Gjeografi”</p>



<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Nga dokumentacioni shoqëruar identifikohen raporte vlerësuese në nivel fakulteti dhe njësisish bazë të cilat përcillen në Rektorat. Si në analizën vjetore të punës së DHGJ ashtu edhe në atë të FSHH apo në procesverbale të mbledhjeve në fokus të vlerësimit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Puna organizative e DHGJ; 2. Kualifikimi dhe Kërkimi Shkencor i personelit akademik të departamentit; 3. Disiplina në Punë; 4. Realizimi i Programeve Mësimorë dhe Cilësia në Mësimdhënie dhe Plotësimi i Dokumentacionit; 5. Mangësitë e identifikuar; 6. Detyrat për të ardhmen; GVJ do të rekomandonte që në të ardhmen vlerësimi i arritjeve të mos ishte përgjithësues por me emra konkret, kjo me qëllim motivimin dhe promovimin e personelit akademik aktiv. <p>EVIDENCA 1.11; EVIDENCA 1.20; EVIDENCA 1.32; EVIDENCA 1.33; EVIDENCA 1.34;</p> <p>Dokumentacioni Shtesë: “Shtesa për BA Histori-Gjeografi”</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni kryen vlerësime periodike ku për çdo semestër realizon vlerësimin me studentët përmes anketimeve; fokus grupe; takime me stafin dhe studentë etj. NJSBC është struktura përgjegjëse për realizimin e procesit të vlerësimit. [RVB]</p> <p>Krahas detyrës që kryen NJSBC departamenti i HGJ përdor instrumente të tërthorta vlerësimi lidhur me cilësinë e programit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komente formale dhe joformale të studentëve; - Takime me ish-studentë; - Pyetësorë; - Takime me Drejtorinë Rajonale Arsimore, Drejtues shkollash; - Sondazhe nga personeli akademik për lëndët që ata lekturojnë; <p>GVJ nga takimi me personelin akademik të njësisë që zhvillon programin HGJ konfirmon realizimin e këtyre formave të tërthorta vlerësimi. Ata i konsideronin ato si një barometër të punës së tyre të përditshme nga njëra anë por edhe si piketa për të vendosur prioritet në të ardhmen.</p> <p>EVIDENCA 1.34; Dokumentacioni Shtesë: “Shtesa për BA Histori-Gjeografi”; Takimi me personelin akademi, Vizita në institucion;</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton se DHGJ kryen pyetësor drejtuar Alumnit që kanë përfunduar programin e studimit Bachelor në HGJ. Në këtë pyetësor informacioni që merret lidhet me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kohën kur janë licencuar si mësues të profilit historigjeografi; 2. Rezultatet e licencimit; 3. A janë të punësuar dhe ku; 4. Ushtrojnë profesionin e tyre apo punojnë në administratë; 5. Punësim Privat/Shtetëror; 6. Punësim në nivel specialist/drejtues etj; <p>GVJ vlerëson profesionalizmin në hartimin e pyetësori dhe qëllimin e realizimit të tij për të bërë vlerësimin e kompetencave që kanë marrë nga ky program studimi por edhe mundësitë e punësimit pas përfundimit të ciklit të parë të studimit.</p> <p>EVIDENCA 5.6; EVIDENCA 5.15;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni UNIEL tregon përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion se monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit Bachelor në HGJ nëpërmjet njërive të posaçme. Instrumentet e realizimit janë intervistat, anketat, komente formale dhe joformale të studentëve, pyetësor drejtuar ish-studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së UNIEL, standardet dhe cilësia, përfshijnë disa struktura si: Drejtoria e Kurrikulave dhe e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila përbehet nga njësi e: a. Njësia e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe b. IT. NJSBC vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore-shkencore, të UNIEL-it. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të tij rregullohet me dokument të veçantë. c. Zyra e Burimeve Njerëzore. Institucioni realizon politika dhe procedura të brendshme të cilësisë duke përfshirë disa aktorë në proces si: Bordet e tregut të punës; ekspert të jashtëm; përfshirja në projekte ndërkombëtare me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme si Erasmus +. Përfshirja në këto projekte ka krijuar shkëmbime përvojash, trajnime, vizita studimore si dhe procese të tjera që lidhen me monitorimin dhe vlerësimin e funksionit e sigurimit të cilësisë së brendshëm.</p> <p>EVIDENCA 1.1; EVIDENCA 1.4; EVIDENCA 5.6; RVB;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat e njësive të angazhuara janë të përcaktuara në kuadrin ligjor si Rregullore e UNIEL, rregullore e FSHH, rregullore e DHGJ, mbi të cilin funksionon UNIEL dhe njësitë përbërëse të tij.</p> <p>Mbështetur në dokumentacionin mbështetës rezulton se ekzistojnë urdhra të rektorit dhe vendime të drejtuesit të njësive bazë për detyra konkrete që njësitë dhe individët angazhohen në organizimin dhe menaxhimin e veprimtarisë kërkimore shkencore dhe koordinimin e saj sektorin e projekteve, kërkimit shkencor dhe të botimeve në UNIEL.</p> <p>EVIDENCA 5.13; EVIDENCA 1.4; EVIDENCA 5.16; EVIDENCA 5.17;</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>NJSBC-ja nuk realizon raporte në nivel program studimi. Gjatë procesit të realizimit të pyetësorit ajo përfshin në sondazhet për vlerësim të gjithë personelin akademik, studentët e Departamentit të HGJ dhe personelin ndihmës akademik. Gjithashtu, siguri i cilësisë së programit bëhet objekt analize çdo fund viti akademik nga vetë njësia bazë që e ofron programin HGJ, nga departamenti.</p>

<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>UNIEL ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit-NJSBC-së si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rotacioni .etj). Anëtarët e NJSBC për njësinë kryesore nuk duhet të jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të universitetit, etj. RVB</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Nga RVB nuk është shumë e qartë nëse ka bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit dhe që marrin pjesë në vlerësimin e brendshëm të cilësisë. RVB</p> <p><i>Gjithashtu GVJ konstaton mungesë të dokumentacionit mbështetës lidhur me rolin që ekspertiza e jashtme duhet të japë në vlerësimin e cilësisë për programin e studimit HGJ.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore konstaton se UNIEL përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Por NJSBC-ja e UNIEL nuk realizon raporte vlerësimi në nivel program studimi vetëm në nivel institucional.</i></p> <p><i><u>GVJ rekomandon vlerësim të veçantë të programit të studimit dhe përfshirjen e ekspertizës së jashtme në vlerësimin e cilësisë për programin e studimit HGJ.</u></i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të një plani veprimi vjetor të miratuar nga Rektori i Institucionit UNIEL. Rregullorja e NJSBCS është dokumenti në të cilin përcaktohen rregullat e organizimit të veprimtarisë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë. Këto dokumente sikundër pranohet në RVB dhe “raportet e NJSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë”. EVIDENCA 6.2; RVB;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Vlerësimi është në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese. Struktura drejtuese përcjell në njësinë bazë ato element që lidhen me këtë njësi. Në departament trajtohet me personelin akademik ato elementë që lidhen ngushtë me veprimtarinë e tyre. Raportet e NJSBC-së janë të aksesueshme për të gjithë stafin akademik e për studentët. RVB</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Sipas RVB-së NJSBC-ja rekomandon detyra. Gjetjet dhe rekomandimet në çdo rast janë shoqëruar dhe me marrjen e masave konkrete.</p> <p>Nga dokumentacioni GVJ nuk hasi në ndonjë dokument që të tregojë rekomandimet e lëna pas vlerësimit nga NJSB dhe nuk u njoh me masat konkrete të marra.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Përmes kontrollit të kryqëzuar, strukturat dhe aktorë të brendshëm të UNIEL reflektojnë mbi rezultatet e raportit dhe realizojnë masa që lidhen me programet e studimit për ta përmirësuar më tej. RVB.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e NJSBC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesin në dokumentat ku bazohet kjo veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional. RVB.</p>

Konkluzione	<i>GVJ konsaton se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë publike, transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë në UNIEL</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes së	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Niveli i përmbushjes së	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor në Histori-Gjeografi”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit “Bachelor në Histori-Gjeografi” është një program i konsoliduar dhe me një traditë shumëvjeçare. Vlen të thuhet se karakteri i dyfishtë i programit (historia dhe gjeografia) u mundëson studentëve që në ciklet në vijim të thellojnë njohuritë e tyre në disa fusha studimi, si dhe u ofron më shumë mundësi punësimi në tregun e punës;
2. Programi i studimit “Bachelor në Histori dhe Gjeografi” ka një peshë të rëndësishme sa i përket konkurrencës në tregun vendas të arsimit të lartë e në atë rajonal;
3. Strategjia e ndërkombëtarizimit në nivel institucional, e shtrirë në nivel fakulteti dhe departamenti, ku organizohet dhe ofrohet programi “Bachelor në Histori dhe Gjeografi”, u mundëson studentëve transferimin e studimeve në universitetet rajonale, kontinentale e më gjerë;
4. Personeli akademik i programit është i kualifikuar, me tituj e grada dhe, po ashtu, ka një përvojë të konsiderueshme në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor;
5. Departamenti i Histori-Gjeografisë në Fakultetin e Shkencave Humanë të UNIEL ka në qendër të punës së tij promovimin e programit të studimit, jo vetëm në rrafshin lokal, por edhe më gjerë;
6. Diploma “Bachelor në Histori dhe Gjeografi” u krijon mundësi të diplomuarve që të ndjekin studimet në ciklin e dytë në Master Profesional e Master i Shkencave në fusha si: mësuesia, marrëdhëniet ndërkombëtare, arkivistika, studimet historike, trashëgimia kulturore, studime gjeografike, etj;
7. Veprimtaria e stafit akademik të Departamentit të Histori-Gjeografisë është e përqendruar jo vetëm në drejtim të zbatimit me rigorozitet të planit mësimor të programit të studimit “Bachelor në Histori dhe Gjeografi”, por edhe në veprimtari kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare dhe përfshirje në projekte (në bashkëpunim me departamentet e tjera të FSHH), duke bërë pjesë të tij dhe studentët e

- këtij programi;
8. Rregullore, udhëzues dhe procedura të mirëpërcaktuara për funksionimin e procesit mësimor;
 9. Një sistem funksional për sigurimin e brendshëm të cilësisë së mësimdhënies, në të cilin përfshihen edhe studentët;
 10. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve;
 11. Një platformë digjitale efikase për realizimin e komunikimit të stafit akademik me studentët, për vlerësimin e tyre;
 12. Një infrastrukturë e re dhe funksionale në shërbim të studentëve dhe stafit akademik;

b. Pika të dobëta:

1. Mungesa e studimeve të mirëfillta për tregun e punës, në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit; (*Standardi II.4, kriteri 7*)
2. Mosrespektim i mbulimit të shpërndarjes së ngarkesë mësimore në raportin 70% PAE dhe 30% PAK; (*Standardi IV.1, kriteri 2*)
3. NJSBC nuk harton raporte për program studimi, por vetëm në nivel institucional; (*Standardi VI.2, kriteri 4*)

Rekomandime:


1. Të vijohet edhe më tej, duke gjetur mjete dhe mundësi të papërdorura më parë, në mënyrë që të shtohet propaganda e cila u bën të ditur të interesuarve se programi i studimit “Bachelor në Histori dhe Gjeografi” mundëson ndjekjen e studimeve të nivelit të dytë edhe në fusha të tjera jashtë mësuesisë;
2. Të rritet promovimi i këtij programi studimi, nëpërmjet një fushate informuese dhe sensibilizuese, për afrimin e studentëve në këtë program;
3. Të përditësohet gradualisht programi i studimit “Histori-Gjeografi”, në drejtim të kurrikulave, duke u prirur drejt përgatitjes së specialistëve që kërkon tregu i punës, si dhe të realizohet ekuivalentimi ose përafrimi i programit mësimor me programe të ngjashme të huaja;
4. Të realizohet një studim i tregut, për të kuptuar kërkesat e kohës, prirjet dhe perspektivën e punësimit që kanë lidhje me këtë program mësimor, si dhe të reflektohen gjetjet e këtij studimi në programin mësimor;
5. Të rritet fondi për pasurimin e bibliotekës së institucionit, duke siguruar kopje të teksteve bazë dhe të literaturës bashkëkohore në dispozicion të studentëve;
6. Të ndryshohet raporti mësimdhënie dhe punë shkencore i stafit akademik, në mënyrë që stafi të angazhohet edhe më shumë me punë kërkimore dhe projekte;
7. Të rritet numri i publikimeve shkencore të stafit akademik, të botuara në revista ndërkombëtare të indeksuara. Të punohet për përputhjen ose përafrimin e profilit shkencor të stafit akademik me mësimdhënien;

8. Të rritet numri i mobiliteteve të studentëve dhe stafit akademik jashtë vendit;
9. Të pasurohet webfaqja e institucionit me informacion të detajuar për programin e studimit, si dhe syllabus-et e këtij programi, shqip dhe në gjuhën angleze, në mënyrë që studentët apo kandidatët për studentë të informohen për to edhe on-line;
10. Rekomandohet që institucioni të gjejë opsione për të lejuar zbatimin e Clean Score, në rastin e provimeve me zgjedhje të shumëfishta, gjë që do të ndihmonte në rritjen e transparencës dhe përmirësimin e procesit të sigurisë;
11. Përditësimi i literaturës me tituj të rinj, kryesisht në gjuhë të huaj dhe në lëmin e gjeografisë, si dhe qasje tek artikujt shkencorë më të fundit, nëpërmjet abonimit në Google Scholar;
12. Në kuadër të ndërkombëtarizmit, të përcaktohen kriteret specifike të përzgjedhjes së studentëve të huaj dhe atyre me aftësi të kufizuara;
13. Të hartohet një manual i metodave më të mira të mësimdhënies;
14. Të vihet më tepër theksi në promovimin e personelit akademik që spikat në arritje;
15. NJSBC duhet të hartojë dokumente ku të pasqyrojë rekomandimet e lëna pas vlerësimit, si dhe të pasqyrojë masat që propozon, me qëllim që të krijojë e Kulturën e Brendshme të Cilësisë;

Conclusions of the external evaluation of the first cycle study program “Bachelor in History and Geography”

a. Strengths and affirmations:

1. The study program “Bachelor in History and Geography” is a consolidated program with a long tradition. It’s worth saying that the double character of the program (history and geography) enables students to deepen their knowledge in several fields of study in the following cycles, as well as offers them more employment opportunities in the labour market;
2. The “Bachelor in History and Geography” study program plays an important role in terms of competition in the local and regional higher education market;
3. The internationalization strategy at the institutional level, extended at the faculty and department level, where the “Bachelor in History and Geography” program is organized and offered, allows students to transfer their studies to regional universities, as well as continental ones and beyond;
4. The academic staff participating in the study program are qualified, hold scientific degrees and academic qualifications, and have considerable experience in teaching and scientific research as well;
5. The Department of History-Geography of the Faculty of Human Sciences of UNIEL has at the centre of its work the promotion of the study program not only locally, but also beyond;
6. The “Bachelor in History and Geography” diploma creates opportunities for graduates to continue their studies in the second cycle (Professional Master and Master of Science), in disciplines such as teaching, international relations, archival studies, historical studies, cultural heritage, geography studies, etc;




7. The activity of teaching staff of the Department of History and Geography is focused not only on the rigorous implementation of the curriculum of the "Bachelor in History and Geography" study program, but also on national and international scientific research activities and on the involvement in various projects (in collaboration with other departments of the FSHH), making the students of this study program part of them;
8. Well-defined regulations, guidelines and procedures for the functioning of the learning process;
9. A functional system for the internal assurance of the quality of teaching, in which the students are also involved;
10. Guidelines at the institutional level for the development and use of different and innovative teaching methods, based on the field of studies, subjects and modules;
11. An efficient digital platform for the communication of academic staff with students, for the evaluation of the latter;
12. A new and functional infrastructure at the service of students and academic staff;

b. Weaknesses:



1. Lack of proper studies on labour market in accordance with national development strategies, national interest and global development trends; (*Standardi II.4, kriteri 7*)
2. Non-compliance with the teaching load distribution ratio, 70% for effective academic staff and 30% for contract academic staff; (*Standardi IV.1, kriteri 2*)
3. NJSBC doesn't compile reports about study programs, but it only does so at the institutional level; (*Standardi VI.2, kriteri 4*)

Recommendations

1. To go even further in search of previously unused tools and opportunities, in order to increase the propaganda aimed at informing interested parties that the study program "Bachelor in History and Geography" enables the pursuit of second-level studies in other fields outside of teaching;
2. To increase the promotion of this study program through an information and awareness campaign, to bring students closer to this program;
3. To gradually update the "Bachelor in History-Geography" study program, in terms of curricula, tending towards the preparation of specialists required by the labour market, as well as to realize the equivalence or approximation of the educational program with similar foreign programs;
4. To carry out a market study to understand the current demands, trends and perspective of employment related to this curriculum, as well as to reflect the findings of this study in the curriculum;
5. To increase the fund for the enrichment of the institution's library, providing copies of basic texts and contemporary literature available to students;
6. To change the teaching and scientific work ratio of the academic staff, so that the staff engages even more with research work and projects;
7. To increase the number of scientific publications of the academic staff, published in indexed international journals, as well as to work on matching or aligning the scientific profile of the academic staff with teaching;



8. To increase the number of mobility abroad for students and academic staff;
9. To enrich the institution's website with detailed information about the study program, as well as the syllabuses of this program, in Albanian and English, so that students or applicants for enrolment can be informed about them online;
10. It is recommended that the institution find options to allow the implementation of Clean Score when multiple-choice exams are applied, which would help increase transparency and improve the safety process;
11. Literature update with new titles, mainly in foreign languages and in the field of geography, as well as access to the latest scientific articles via subscription to Google Scholar;
12. In the context of internationalization, specific criteria must be defined for the selection of foreign students and those with disabilities;
13. To draft a manual of the best teaching methods;
14. Greater emphasis should be placed on promoting academic staff who are distinguished by their achievements;
15. NJSBC must draft documents to reflect both the recommendations made after the evaluation and the measures it proposes, in order to create an Internal Quality Culture;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Plotësisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

